

**Edukimi per  
te Drejten Demokratike  
te Qytetarise**

Keshilli i Evropes

Strasbourg, 26 qershor 200

DGIV/EDU/CIT (2000)23

**KESHILLI PER KOOPERIM KULTUROR (CDDC)**

**PROJEKTI “ EDUKIMI PER TE DREJTEN  
DEMOKRATIKE TE QYTETARISE”**

Konceptet baze dhe kompetencat  
themelore per edukimin e te drejtes  
demokratike te qytetarise.

Prof. Francois Audiger  
Universiteti i Gjeneves, Zvicer

Mendimet e shprehura ne kete punim jane mendimet e vete autorit dhe nuk pasqyrojne domosdoshmerisht politiken zyrtare te Keshillit per Kooperim Kulturor prane Keshillit te Evropes dhe as ate te Sekretariatit.

Per cdo korrespondence lidhur me kete raport ose per cdo riprodhim apo perkthim te te gjithë ketij dokumenti apo te pjeseve te vecanta te tij i duhet drejtuar Drejtorise se Pergjithshme IV , Keshilli i Evropes, F-67075, Strasburg Cedex.

Ne vitin 1997 filloi zbatimi i projektit “Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetare”, me qellim zbulimin e vlerave dhe aftesive qe kerkojne individet per t’u bere qytetare pjesemarres (aktive), si dhe per te zbuluar menytrat sesi ata mund t’i perftojne keto aftesi dhe sesi ata mund te mesojne qe t’ua percjellin keto te tjereve.

Qysh ne fillim te projektit u krijua Grupi i Projektit, i perbere nga perfaqesues te Ministrise se Arsimit, specialiste, institucione nderkombetare dhe organizata joqeveritare (NGO), aktive ne fushen e edukimit per te drejten demokratike te qytetare. Veprimtarite e projektit, te bazuara, si ne teori ashtu edhe ne praktike, ne jeten e perditshme, u ndane ne tri nengrupe. Ato punuan me:

*A- konceptet/ perkufizimet:*

Qellimi : perpunimi i nje kuadri konceptesh mbi edukimin per te drejten demokratike te qytetare, se bashku me terminologjine perkatese, dhe identifikimi i aftesive baze, te kerkuara per praktikat demokratike ne shoqerite evropiane.

*B- projektet pilote/ fusheveprimi i se drejtes se qytetare:*

Qellimi : te identifikojne, te mesojne nga, te krahasojne, vleresojne dhe inkurajojne zhvillimin e fusheveprimit te se drejtes se qytetare ( iniciativat novatore dhe inkurajuese, ne te cilat qytetaret marrin pjese aktive ne shoqeri, vecanerisht ne nivel lokal ). Po keshtu, identifikohen dhe mbeshteten partneritetet mes aktoreve te ndryshem, te perfshire ne edukimin per te drejten e qytetare ( sic jane psh. shkollat, prinderit, media, bizneset, autoritetet lokale, institucionet arsimore per te riturit ).

*C- sistemet e kualifikimit dhe ato mbeshtetese( ndihmese):*

Qellimi: identifikimi i metodave dhe rrugeve te mesimit, te mesimdhencies dhe te kualifikimit, krijimi i nje rrjeti “amplifikuesish”, edukatoresh per te riturit dhe instruktoresh per edukimin me te drejten demokratike te qytetare, shkembimi i informacionit dhe eksperiences ne fushen e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetare ( EDC ) dhe krijimi i forumeve per te reflektuar dhe diskutuar.

Aktivitetet kryesore, te ndermarra gjate periudhes se viteve 1997- 2000, kane rezultuar, mes te tjerash, ne raportin sinteze te projektit dhe ne tri studime suplimentare, te paraqitura ne konferencen perfundimtare te projektit, qe u mbajt ne Strasburg, nga 14 deri 16 shtatori i vitit 2000.

Pervec raportit aktual, jane edhe:

- Edukimi per te drejten demokratike te qytetare : Perspektiva e te Mesuarit gjate gjithë jetes, nga Cesar Birzea, raport sinteze i gjithë projektit mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetare.

- Fushat e veprimit te se drejtes se qytetarisë: Kompetencat, pjesemarrja dhe partneritetet nga Liam Carey dhe Keith Forrester.
- Strategjite per te mesuar te drejten demokratike te qytetarisë nga KH Duerr, V. Spajic-Vrkas dhe I.Ferreira Martins.

Informacion te metejshem mbi veprimtarite, studimet, raportet dhe botimet rreth Projektit te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarisë (EDC) mund te gjeni ne faqen e internetit ne adresen : <http://culture.coe.int/citizenship>

## **TABELA E LENDES**

	<b>Faqe</b>
<b>HYRJA</b>	<b>7</b>
<b>1.SHQETESIMI NE RRITJE PER CESHTJE QE LIDHEN ME TE DREJTEN E QYTETARISE</b>	<b>8</b>
1.1 Disa hipoteza dhe interpretime	<b>8</b>
1.2 Kufizimet, paradokset dhe masat paraprake	<b>10</b>
<b>2.KONTEKSTI, KONTEKSTET</b>	<b>11</b>
<b>3.QYTETARI, E DREJTA E QYTETARISE :THELBI, VARIACIONET DHE SFIDAT KONCEPTUALE</b>	<b>15</b>
3.1 Thelbi	<b>16</b>
3.2 Variacionet dhe sfidat konceptuale	<b>19</b>
<b>4.KOMPETENCAT THELBESORE</b>	<b>21</b>
4.1Klasifikimi i pare	<b>21</b>
4.2Klasifikimi i dyte	<b>23</b>
<b>5.PRAKTIKAT</b>	<b>24</b>
5.1Grupet objekt dhe fushat ku synohet te behet nderhyrja: te gjithë individët, te gjitha institucionet	<b>25</b>
5.2”Fusheveprimet e se drejtes se qytetarise”	<b>25</b>
5.3 Praktikate ne ambjentin shkollor	<b>26</b>
5.4 Te mesuarit gjate gjithë jetes dhe fusha te tjera	<b>28</b>
5.5 Metodate konvergjente, veshtiresite e njejta	<b>29</b>
<b>6.DISA RREZIQE</b>	<b>30</b>

Qellimi i ketij studimi eshte shqyrtimi i koncepteve baze dhe kompetencave thelbesore te edukimit per te drejten demokratike te qytetare (EDC). Ai trajton dhe ploteson nje raport fillestar te konsoliduar, te perhapur nen referencen DECS/CIT ( 98) 35. Ai mbeshetet kryesisht ne punen e kryer, se fundi, nen patronazhin e Drejtrise se Arsimit, Kultures dhe Sportit ne kuadrin e projektit “ Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetare” (EDC). Ai u plotesua nga aktivitetet e zhvilluara ne te kaluaren dhe ato aktuale, te ndermarra nga kjo Drejtori dhe nga drejtori te tjera. Rezultatet e ketyre veprimtarive gjenden ne raportet e poshteshenuara :

- Drejt nje te drejte demokratike qytetare, 1994-1995, nga Ettore Gelpi
- Nje permbledhje dhe konkluzionet e Konferences perfundimtare te projektit “Demokracia, te drejtat e njeriut, minoritetet : aspekte arsimore dhe kulturore”, nga Etienne Grosjean
- Raporti i takimit konsultativ mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetare (EDC) , nga Cesar Birzea
- Dokument parapergatitor, nga Ruud Veldhuis, dhe raporti nga Marino Ostini mbi seminarin me teme : “ Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetare: konceptet baze dhe kompetencat thelbesore”.
- “Policia dhe te drejtat e njeriut: ceshtje e nje praktike te mire”, konference e mbajtur nga 10 deri 12 dhjetori i vitit 1997.
- Liber mesimi per mesimdhene praktike: te drejtat e njeriut dhe policia, viti 1998.
- Kujtese dhe qytetari: nga vendet tek projektet, seminar ne Delfi, mbajtur nga 25 deri 27 shtatori i vitit 1998.
- Pjesemarrje demokratike ne Arsim dhe Kualifikim, seminari ne Lilehammer, mbajtur nga 22 deri me 24 tetor i vitit 1998.
- Dhuna ne shkolla: rritja e vetedijes, masat parandaluese, ndeshkimet, Simpoziumi i Brukselit nga 26 deri 28 nentori i vitit 1998.
- Kulturat, menytrat e jeteses dhe e drejta qytetare e te rinjeve, Seminari i Budapestit, nga 8 deri 13 dhjetori i vitit 1998, e plotesuar nga studimi me teme : “Kultura e rinise dhe modernizimi: nje bote ne krijim”
- Permbledhje e raporteve te anetareve te grupit te projektit “ Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetare”, 17-19 shkurt 1999.
- Sfidat e edukimit shkencor, Forumi i Komitetit te Arsimit, Strasburg me 30 mars te vitit 1999.
- Diversiteti linguistik per te drejten demokratike te qytetare ne Evrope, Konferenca e Innsbrukut, nga 10 deri me 12 Maj 1999.
- Studimet evropiane mbi te drejten demokratike te qytetare, raportet paraprake, 1999
- Shoqeria e tregut, demokracia, e drejta e qytetare dhe solidariteti : nje fushe konfirmimi? Konferenca e parlamentareve dhe organizatave joqeveritare (NGO-ve), Strasburg , nga 31 maji ne 1 qershor te vitit 1999.
- Lista e Vendimeve te Nen-Grupit A te Projektit mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetare, 31 maj deri 1 qershor te vitit 1999.
- Seminar mbi kompetencat dhe pergjegjesite : nga parimi ne praktike , Delfi, tetor 1999.
- Ide gjeniale dhe studimi mbi “ Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetare dhe Kohezioni Shoqeror “, 15 dhe 16 nentor 1999.

- Konferenca mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarise: metodat, praktikat dhe strategjite, Varshave, 4 deri me 8 dhjetor 1999.

- 
1. I gjithe projekti paraqitet ne Internet, ne adressen: <http://culture.coe.fr/postsummit/citizenship>
  2. Ne kemi vendosur te mos citojme te gjithe autoret, ne menyre qe teksti te kete nje gjatesi te arsyeshme. Vetekuptohet se, mendimet e shprehura ketu burojne nga raportet e ndryshme , te cilat, ne vetvete, jane tashme paraqitje te konsoliduara te studimeve te shumta, te ndermarra ne rrethana te ndryshme, me aktore qe vijne nga te gjitha shtetet anetare te Keshillit te Evropes.

## HYRJA

Ne pak dekada, fjala “ e drejta e qytetare ” eshte bere nje nder fjalet me te perdorshme ne diskutimet mbi jeten komunale ne shoqeri. Ajo i jep drejtim pergjigjes sone, te ciles ne shpesh i referohemi si krize ne strukturen sociale dhe ne kohezionin ( unitetin) shoqeror. Koncepti mbi te drejten e qytetare perdoret, vecanerisht, ne perpjekjet per te stabilizuar dhe ndryshuar disa praktika qe perfshijne shkollat dhe, ne pergjithesi, arsimin dhe kualifikimin. Megjithate, duhet te shkojme pertej konsensusit te vaget te reflektuar ne perdorimin konstant te ketyre formulimeve te gjera, me qellim qe, te mund te marrim drejtimin ne debatet e nxehta mbi te drejten e qytetare. Nje term i tille, i nje rendesie kaq te madhe historike dhe sociale, nuk mund te perdoret kaq lehte : ai nuk duhet te reduktohet ne nje seri lutjesh te vagta, qe synojne te paqesoje fqinjat problematike ose te rivendosin disa rregulla per shkollat e crregullta. Respekti per ligjin dhe ndjenja e pergjegjesise, te cilat jane kushtet paraprake per cdo shoqeri demokratike, nuk mund te reduktohen ne nje bindje pasive ndaj nje rendi shoqeror te drejte e te qendrushem. Renia e regjimeve komuniste ne Evrope dhe konsensusi i dukshem mbi te drejten demokratike te qytetare nuk i zhduku debatet, divergjencat, dhe sigurisht edhe konfliktet mes shteteve, grupeve dhe individeve te ndryshem.

Keto ndryshime nuk burojne vetem nga traditat e ndryshme kulturore dhe sociale, qe ,ne nje te ardhme te afert, jane te destinuara te misherohen ne nje te drejte globale hipotetike te erret te qytetare; ato reflektojne gjithashtu menytrat e ndryshme te vleresimit te botes se sotme, te rivleresimit te vazhdueshem te se shkuars sone ( te te shkuarave tona) dhe te percaktimit te parashikimeve tona, te se ardhmes sone ( te te ardhmeve tona). Eshte disi ironike te trumpetosh koncepte te lirise e te pergjegjesise, te apelosh per iniciativa individuale dhe te brohorasesh per diversitetin si nje asset/pasuri e vyer e shoqerive tona, dhe ne te njejten kohe t’i rrethosh keto deklarata me biseda mbi kerkesa apo detyrime te padiskutueshme dhe te qendrueshme per zhvillimet globale. **Liria e qytetarit, apo se paku, nje forme e caktuar tradicionale e saj, eshte liria e shoqerise dhe diskutimi ne nje ambient publik, i udhehequr, teorikisht, nga barazia midis te gjithe individeve.**

Natyrisht, pjesa me e madhe e studimeve te kryera se fundi, pajtohet me mendimin se shoqerite tona kane ndryshuar ne menyre radikale. Dhe se bashku me to edhe konceptimet teorike dhe zbatimet praktike te se drejtes se qytetare. Permbajtja e ketij koncepti po zgjerohet e po rritet krahas shumellojshmerise se menyrave te presences se tij ne bote dhe te marredhenieve te tij me te tjeret. Aleancat dhe pranimet/anetaresimet po shumefishohen dhe po behen me fleksibel. Me shtetin, vecanerisht me Shtetin-Komb, nuk i referohemi me nje magazine baze apo legjitime te pushtetit : baze ne sigurimin e modelit per bashkeekzistence ne nje bote me teritore te ndare me kufije te qarte, dhe legjitime ne perfaqesimin e mireqenies se pergjithshme te te gjithe qytetareve.

Reflektimi mbi konceptet e edukimit per te drejten demokratike te qytetare eshte pjese integrale e veprimit : reflektimi i jep kuptim veprimit dhe e kunderta. Reflektimi dhe veprimi nuk qendrojne ne nje raport hiriarik me njera tjetren, as permes ndonje

“maredhenieje te terthorte” dhe as brendaperbrenda dy sferave te vecanta. Veprimi mbeshetet gjithnje nga konceptimi i aktoreve, ndersa reflektimi e ushqen vazhdimisht kete veprim dhe merr kuptim duke iu referuar eksperiences. Eksperienca mund te marre kuptim vetem me mendimet dhe fjalet qe perdoren per te shprehur, drejtuar apo ushqyer kete mendim. Tipi i te menduarit, ketu, eshte dialektik, edhe pse, per aresye te perfitimit editorial, disa tekste perqedrohen me shume ne eksperiencen dhe, per pasoje, edhe ne diversitetin global ekzistencial, nderkohe qe te tjere, sic eshte rasti i dokumentit aktual, terhiqen disi nga eksperienca konkrete. Sfida ka te beje me bashkimin (shkrirjen ne nje te vetme) te eksperiencave, pikepamjeve dhe imagjinatave te panumerta, te perjetuara e te shprehura ne universet e ndryshme kulturore dhe sociale. Ky studim konceptesh duhet te shihet, para se gjithash, i lidhur me raportet e Keshillit te Evropes dhe me botime te tjera te tij dhe, se dyti, me tekstet qe finalizojne projektin mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarisve. Te gjitha keto tekste e kane furnizuar dhe frymezuar kete studim. Mbi dhe pertej shumellojshmerise se gjere te informacionit, ne duhet te kemi parasysh vec e vec referencat perkatese, “shtratin e patjetersueshem (bedrock) te te drejtave te njeriut” dhe institucionet politike demokratike.

Ky studim fillon me nje paraqitje, ne vija te trasha, te permbajtjes se tij sociale. Para se gjithash, shqyrtohet nje numer aspektesh lidhur me interesin ne rritje per te drejten e qytetarisve dhe pershkruhen kufijte e ketij studimi, te cilat, diktohen, pjeserisht, nga percaktimet e ndryshme, te mundshme te qytetarit si individ. Ne pjesen e dyte perdoren studime te ndryshme te Keshillit per te zhvilluar diskutimin mbi te drejten e qytetarisve. Studimi perqendrohet tek te rinjte, pasi edukimi eshte, para se gjithash, nje ceshtje qe i perket rinise si dhe tek autoritetet publike, duke perdorur shembullin e policise. Dhe se fundi, ne menyre me te pergjithshme, shqyrtohen marredheniet midis shtetit, shoqerise civile dhe tregut, nje ceshtje kjo teper aktuale. Kjo paraqitje e aspekteve te permbajtjes se pergjithshme pasohet nga shpjegimi i konceptit te se drejtes qytetarisve, bazuar mbi nje model, i cili percakton nje “thelb vital”, pa te cilin mendimi i vertete mbi te drejten e qytetarisve, do te konsistonte ne pohime e deklarata te paqarta e te turbullta dhe ne nje seri fushash veprimi, te cilat jane ende ne proces diskutimi e zhvillimi. Kjo menyre ve ne dukje shume “sfida konceptuale”. Me poshte vazhdohet me paraqitjen e dy kualifikimeve te mundshme te kompetencave thelbesore, te cilat synojne te nxjerrin ne pah aktivite, duke i kombinuar ato ne nje teresi te vetme, duke u dhene atyre nje kuptim me te gjere dhe duke inkurajuar koherencen / lidhjen logjike te tyre. Kjo do te na mundesoje te nxjerrim ne pah se cfare mbulohet dhe cfare jo nga nje aktivitet, me qellim qe te garantojme veprimtari te tjera per ta kompletuar kete studim. Pjesa e fundit pershkruan mjetet e ndryshme praktike per zbatimin e projektit “Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarisve”, duke konkluduar ne nje riafirmim te natyres problematike dhe dinamike te se drejtes se qytetarisve. Eshte jetike te vazhdohet te reflektohet, teorikisht dhe praktikisht, mbi nje ceshtje ne metamorfoze konstante. Na mbetet vetem te shpresojme se, ceshtja e te drejtes demokratike te qytetarisve do te vazhdoje te jete gjithnje nje ceshtje aktuale dhe se ne nuk do te mund kurre t’i lajme duart nga kete ceshtje.

# 1.SHQETESIMI NE RRRITJE PER CESHTJE QE LIDHEN ME TE DREJTEN E QYTETARISE

## 1.1 Disa hipoteza dhe interpretime

Ky studim, i cili është realizuar mbi bazën e punës së kryer vitet e fundit, nuk merr parasysh gjithçka që është bërë mbi dhe për çështjen e edukimit qytetar qysh kur Këshilli i Evropës filloi ta trajtojë atë. Kjo kushtëzon nevojën e studimeve plotësuese, realizimi i të cilave do të ishte natyrisht shumë i vlefshëm. Për një studim historik do të tregonte, padyshim, se afirmimi dhe zgjerimi i termimit “e drejta e qytetarise” lidhet me zhvillimet aktuale.

Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, përfshirë tekstin mbi krijimin e Këshillit të Evropës, nuk i përfshin termit “qytetar” ose “e drejta e qytetarise”. E vetmja shprehje që i referohet kësaj, gjendet në Nenin 4, i cili bën fjalë për “punën e detyruar ose të detyrueshme” për të hequr nga kjo kategori “çdo lloj pune ose shërbimi, i cili është pjesë e detyrimeve civile normale.” Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut nuk është prolixë (e mbushur me fjale); termi “e drejta e qytetarise” po kështu, nuk përdoret këtu, ndonëse në gjuhë, këtu, termi “nacionalitet/ kombesi”, i cili përdoret për të treguar se kjo është një e drejtë. Përkatesia në një komunitet politik është, para se gjithash, përkatesi dhe lidhje me një shtet, kuadri ligjor i të cilit përcakton kushtet e kësaj përkatesie, të cilësuar si nacionalitet/kombesi. E drejta e qytetarise lidhet me kombesinë, kjo e fundit i jep të parën të drejtat që lidhen me të. Termi “nacionalitet/kombesi” përmbledh kuptime të ndryshme, dhe për më tepër, aplikohet në situata nga me të ndryshmet. Kështu, në tekste të ndryshme ndërkombëtare përdoren termit “person”, shpesh “individ”, “njeri” (në kuptimin e “qenies njerezore” dhe jo në kuptimin e gjinisë mashkullore të kësaj specie) dhe jo termi “qytetar”.

Një studim relevant/ i ngjashëm mund të trajtojë përdorimin e ndryshueshëm të terminologjisë si shenjë e ndryshimeve në interesa dhe koncepte. Mbi dhe përtej vokabularit/fjalorit dhe metodave të ndryshme, të adoptuara nga sisteme të ndryshme arsimore, fokusi ynë është zhvendosur, përfshirë nga “instruksioni civil” në “edukimin civil” dhe tashmë në “edukimin për të drejtën e qytetarise” ose, në fakt, në shumë vende në “edukimin për të drejtat qytetare”. Ky zhvillim reflekton dy tipe ndryshimesh: së pari, kalimin nga një metode, në të cilën prioriteti kryesor në mesimdhënie ishte njohja-vecanerisht me institucionet politike lokale, rajonale ose kombëtare-në një metode, e cila ve theksin në eksperiencën individuale dhe në gjetjen e praktikave, të përcaktuara për të nxjerrë qendrime e sjellje që shprehin respektin e duhur për të drejtat e njeriut dhe për të drejtën demokratike të qytetarise; ndryshimi i dytë është një zgjerim i konsiderueshëm i kësaj fushe, i shprehur në dy kuptime- nga njëra anë tregon se asnjë aspekt i jetës komunitare nuk është i përfshirë për të drejtën e qytetarise- dhe nga ana tjetër ve theksin në institucionet e vendit e interesuara, duke theksuar se thirrja për edukimin me të drejtën e qytetarise e kapërcen ambjentin shkollor, me të cilën ai është i lidhur tradicionalisht. **Kështu, qytetaret e përcaktuar në lidhje me autoritetin politik, të cilët i perkasin, duket se po u hapin rrugë qytetareve, të cilët shihen si individë që jetojnë në shoqëri se bashku me njëzë të tjerë, në një shumëllojshmeri situatash e rrethanash.**

Le të guxojmë të japim një shpjegim për këto zhvillime. Terma të tilla si “ person”, “individ” dhe “ njeri”, prezenca e të cilave në tekste ndërkombëtare është theksuar tashmë, afirmojnë epersinë e të drejtave individuale ndaj të drejtave kolektive, vecanërisht të atyre ( të drejtave) të shteteve; ato e mbrojnë individin nga rreziku i abuzimit me pushtetin , pavarësisht nga origjina e tij; dhe në përputhje me konceptimin aktual të të drejtave të njeriut në Evropë, ata e vendosin individin në krye të shoqërisë dhe lenë të kuptohet se të drejtat e vecante, të vendosura në çdo shtet duhet t’i nënshtrohen parimeve të të drejtave të njeriut, të përcaktuara ndërkombëtarisht. **Shoqëria përbehet nga njerezit dhe është ndërtuar për njerezit.** ( Ri) Shfaqja relativisht e re e termit “ qytetar” duhet të jetë, në këtë mënyrë, një rrugë për t’u kthyer tek çështja e “te jetuarit së bashku”, një çështje kjo, që pak a shumë është harruar për disa dekada në shtetet demokratike, por që tani po rritet shumë shpejt sërisht nën presionin e faktorëve të ndryshëm siç janë: përjashtimi i një pjese gjithnjë e më të madhe të popullsisë, zgjerimi i globalizimit të ekonomisë dhe të kulturave, kjo e fundit e përhapur përmes medias ndërkombëtare , duke vënë në dyshim referencat politike të dy shekujve të kaluar në Evropë si Shtetin-Komb, dhe dimensionin social me të fundit të Shtetit të Mireqenies, rreziqet e fragmentarizimit etnik dhe rritjen e vecorive ekskluzive, sfidat ndaj vlerave baze të shoqërisë tona, fenomenin e racizmit e të ksenofobisë, etj. Disa shkruajtës shprehin se koncepti i punës është i pandashëm nga ai i kohezionit social, i cili nënkupton se përjashtimi nga bota e punës është një nga shkaqet kryesore të kercenimit ndaj kohezionit social. Zhvillimet në tregun e punës dhe në politikat sociale synojnë të tregojnë se as tregu dhe as nderhyrjet në sferën sociale nuk janë të mjaftueshme t’i rivendosin plotësisht këtë kohezion. Kjo përperjekje ka nevojë për nderhyrjen aktive të të gjithë qytetarëve, vecanërisht përmes shoqatave vullnetare, megjithatë kjo nuk e përjashton nevojën për institucionet publike. Psh, operatorët sociale vullnetare nuk do të përfitonin kurrë nga rrjeti i sigurimeve, që aplikohet nga shtete të ndryshme në formën e të ardhurave minimale. Këtu kemi të bëjmë me një rast që me shumë siguri bashkëveprimi së bashku zëvendësimin e një agjencie me një tjetër. Afirmimi i së drejtës demokratike të qytetarëve synon të jetë “ një përgjigje ndaj ndryshimeve të mëdha që realizohen në shoqëritë tona dhe ndaj mungesave në strukturat tona politike, ekonomike, sociale dhe kulturore”( Raymond Weber).

**Kështu, kemi kaluar nga konceptimi i të drejtës së qytetarisë, i cili e vinte theksin në ndjenjen e përkatesisë dhe ku edukimi përkates qytetarëve të shoqërisë këto kalim e vinte theksin shumë fortë në ndjenjen e bindjes ndaj rregullave kolektive në një konceptim me të individualizuar e me të instrumentalizuar të së drejtës së qytetarisë, të një të drejte qytetarie që i hap vend individit dhe të drejtave të tij dhe që i kalon në plan të dytë identitetet kolektive dhe të pjesshme , në kuptimin gjeografik e kulturor, identitete këto që mishërohen nga shtetet. Identiteti dhe përkatesia ndryshojnë dhe shprehin në rrethana të reja dhe në kuptime të tjera, të cilat duhen kuptuar e zotëruar nga ne. Jeta po reflekton gjithnjë e më me forcë fuqinë e imagjinatës, emocionet dhe ndjenjen emotive në ndërtimin dhe shprehjen e këtyre identiteteve individuale dhe kolektive.**

## 1.2 Kufizimet, paradokeset dhe masat paraprake

Perpara se te kthehemi ne aspekte te vecanta te ketij konteksti, nevojitet te parashtrojme kufizimet, paradokset dhe masat paraprake te ketij studimi. E drejta e qytetarise dhe edukimi per te drejten e qytetarise ndryshojne ne menyre radikale fushat , te cilat ndikojne ne te gjitha aspektet e jetes ne shoqeri. Ne kete menyre, ne kete fushe eshte e pamundur te vendosen kufije te sakte e te ciluara nga subjektivizmi dhe gjithnje mund te ekzistojte dyshimi se autori ka harruar apo tradhetuar dicka. Burimet e perdorura per kete studim, bile edhe ato qe kane ardhur vetem nga Keshilli, ne kuptimin material, riprodhojne ne menyren e tyre diversitetin e metodave, percaktimeve dhe kendveshtrimeve te shprehura e qe veprojne ne kontinentin Evropian. Ndonese gjate leximit te tyre shfaqen konvergjenca ( perputhje mendimesh) te vecanta, ekzistojne gjithashtu shume dallime dhe bile edhe kundervenie. Nje gje e tille eshte normale dhe e deshirueshme ne cdo fushe demokratike. Per kete arsye do perpiqemi te hedhim drite mbi pikat e forta por edhe mbi divergjencat dhe mosmarreveshjet, si dhe ne ftesat e shumta per te zhvilluar debate dhe ndermarre studime.

Nje kufizim tjetër lidhet me ate cka pritet te realizohet nga edukimi per te drejten e qytetarise dhe fjalet qe duhen perdorur kur flitet per te. Ketu ekziston rreziku i “fundosjes” se te drejtes se qytetarise ne nje vision sa idilik aq edhe normativ, duke iu referuar atij ne menyre te vazhdueshme per cdo aktivitet apo veprimtari sociale, pa e patur gjithnje te qarte se cfare kerkon nje reference e tille. Per kete eshte e nevojshme t’i kushtohet kujdes i vecante fjaleve qe duhen perdorur kur flitet per te drejten e qytetarise, per ndryshimet ne te dhe per veprimet qytetare, sic jane “ pjesemarrja”, “pergjegjesia”, “ qytetaria e shumefishte”, “identitet shumeracash, i pasur ne diversitet, “ edukim informal” etj , pa harruar pergjithesimet qe perfshihen ne kategorite qe perdorim kur flasim per boten dhe njerezit, si : “rinia”, “ kultura”, “shoqeria civile”, “ kriza e shtetit-komb” si dhe ajo e shtetit te mireqenies, etj. Keto fjale jane te rendesishme per ne kur mendojme e veprojme, por ne duhet te jemi dyshues (skeptik) ndaj shfaqjes se qarte te tyre, ndaj thjeshtezimeve ku mund te cojne ato, ndaj rolit qe ato mund te luajne si slogane te reduktimit te mendimit. Eshte e qarte se, autori nuk eshte i imunizuar as ndaj perdorimeve te tilla dhe as jashte sloganeve aktuale. Prandaj, eshte e nevojshme qe vazhdimisht te mbajme parasysh faktin se fjalet nuk jane sende, dhe se ky studim dhe gjithte tekstet mbi te cilat bazohet ai , jane punime intelektuale, te cilat perpiqen, secila ne menyren e vet, te beje te qarte ( te kuptueshem ) nje realitet te paqendrueshem e te ndryshem, i cili rishpiket ne menyre te vazhdueshme nga aktoret dhe individet ne rrethana pafundesisht te ndryshueshme. Ne situatat e caktuara, ku gjithkush e gjen veten, ne shkolla apo ne vende te tjera ku eshte i pranishem edukimi per te drejten e qytetarise ose si nje projekt ekspllicit ( i qarte) ose si nje qellim me diskret( me i fshehte), eshte e mundur te realizohen vetem gjera te kufizuara e modeste. Dimensionet pragmatike, vemendja ndaj realitetit dhe njerezve jane kushte thelbeshore per arritjen e suksesit. Kjo modesti eshte vete garancia e suksesit te ketyre veprimeve dhe e kontributit te tyre per afirmimin, zhvillimin dhe thellimin e te drejtes demokratike te qytetarise.

Dhe se fundi, ky tekst eshte nje sintheze konceptuale, qe perpiqet te bashkoje se bashku gjithcka qe lidhet me te drejten demokratike te qytetarise, sikurse kjo konceptohet sot dhe

qe lidhet me praktikat edukative ne shumellojshmerine e tyre te madhe, praktika keto, qe behen shkak per refleksion konceptual. Konceptet e ndryshme, prezenca dhe rendesia e te cilave eshte theksuar ne keto faqe, nuk funksionojne te izoluara, por ne kuadrin e nje rrjeti te tere, duke kerkuar njeri tjetrin, duke i dhene kuptim dhe permbajtje njeri tjetrit, ne perputhje me marredheniet e vendosura, dhe modelet e te menduarit mbi realitetin dhe veprimin. Eshte e qarte se, duke patur parasysht polise mine e koncepteve te parashtruara ne kete studim, duhet thene se, ka shume modele te tilla. Kudo ku eshte e mundur, do te mundohemi te shpjegojme aspekte te vecanta te ketyre modeleve. Keto perpjekje mbeten ne periferine e ceshtjeve shume me delikate, qe lidhen me konceptime, qe secili nga ne ushqen / ka per qeniet njerezore, per jeten ne shoqeri, per ate cka i ben njerezit te veprojne ndryshe, per rendesine qe ka lidhja me traditen, trashegimine ose me te rejtat, dhe per rrugen /menyren sesi ne e shohim fatin kolektiv dhe te ardhmen e shoqerive tona.

Keshtu, psh, marredheniet midis qytetareve dhe institucioneve politike publike ne hapësirën demokratike Evropiane mendohen si marredhnie qe shtrihen midis dy poleve. Njera e ben qytetarin suvran absolut, anetar te nje komuniteti lokal, i cili prane autoriteteve te larta delegon vetem ato ceshtje, te cilat nuk mund t'i trajtoje apo t'i zgjidhe vete ; tjetra e sheh qytetarin, para se gjithash, si nje anetar te nje komuniteti politik kombetar, institucionet e te cilit jane garantuesit e te drejteve dhe lirive qe gezon ky qytetar. Ne rastin e pare, pushteti qendror eshte gjithnje nje kercenim ndaj lirive individuale; ne rastin e dyte ky pushtet eshte kushti i vertete per lirite, dhe kuptohet se, ne te gjitha nivelet dhe ne te dy rastet, ky pushtet eshte burimi i qytetareve te lire e te barabarte, dhe se ata qe e ushtrojne kete pushtet ndodhen nen kontrollin e te njejteve bashke- qytetare. Ky ndryshim ne konceptim nuk eshte kurre absolut dhe midis ketyre dy poleve ekzistojne pozicione te ndermjete te ndryshme, ne vartesi te vendit.

## **2.KONTEKSTI, KONTEKSTET**

E gjithë puna e Keshillit, edhe kur kjo lidhet direkt ose indirekt me Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarise, e ve theksin ne rendesine qe ka konteksti. Me kontekst nenkuptojme ose ambientin, ne te cilin jeton dikush ose nje objekt, transformimi i te cilit eshte i nevojshem per te afirmuar parimet qe lidhen me te drejtat e njeriut. Ne kete kuptim te dyte, kemi te bejme me ceshtjen e modifikimit te kontekstit, apo, me konkretisht, te konteksteve, per te lejuar me mire gjithesecilin te ushtroje te drejtat e veta. Permendim ketu psh. rastin e levzjes se lire te njerezve e te mallrave, perfshi edhe ate te te mirave kulturore dhe te ideve, te hapjes se medias ndaj diversitetit kulturor, jo te nje prej mediave per secilin person apo per secilin grup, por me teper per te gjitha mediat te hapura ndaj te tjereve, ndaj prodhimeve kulturore te te tjereve; kjo hapje ngre gjithashtu ceshtjen e aksesit te gjithsecilit ne media, qe ne pjesen me te madhe eshte shume e kontrolluar etj. Po keshtu, nje rast tjetër ka te beje, gjithashtu, me gjithcka qe lidhet me modifikimin e kontekstit, si psh me zhvillimin e marginalizimit dhe te perjashtimit ekonomik e social.

Shqetesimi ndaj kohezionit social qendron ne qender te te gjitha analizave kontekstuale. Fjalori/vokabulari ne baze te ketij shqetesimi shpesh zgjeron pamjen negative dhe pesimiste te shoqerive tona dhe shprehet me: fragmentarizimin, pasigurine, korrupsionin, destabilitetin, infiltrimin e Mafias, diskriminimin, pabarazine ne rritje, individualizimin dhe “rendjen pas numrit nje” konkurrencen e dhunshme etj. Keto terma teper polisemike, qe ne i kemi perdorur si shembuj, perfshijne nje mori te gjere realitetesh. Keto terma dykuptimore perdoren per te pershkruar situata, te cilat disa i shohin si problematike e te tjere si pozitive; psh fragmentarizimi eshte gjithashtu diversitet, konkurimi nenkupton iniciative dhe destabiliteti mund te jete gjithashtu levizje. Pa i minimizuar problemet dhe vuajtjen e njeriut, qe shpesh e shoqeron procesin tashme te percaktuar, nje akumulim i tille mund te jete teper alarmant dhe duhet te ruhem ( mos i kemi bese) lajmeve alarmuese. Ekziston rreziku i imponimit te nje vizioni mbi nje bote, te ndare ne fitues dhe humbes, ne anetare te brendshme e te jashtem; ne kete skenar humbesit/ te jashtmit duhet te fajsojne vetveten per situaten e tyre per arsye te pamundesise qe kane per te pranuar detyrimet e kesaj bote ne ndryshim dhe per te treguar iniciativen e nevojshme. Eshte esenciale te analizohen shkaqet dhe konfiguracionet e sakta te ketyre proceseve, te cilat ndryshojne sipas vendeve, shoqerive dhe kulturave, ne te cilat jetojne te interesuarit.

Ideja e duhur per kontekstin perfshin realitete, te cilat mund te analizohen ne menyra te ndryshme. Psh, ne kete drejtim, mund te dallojme nivele te ndryshme :

- Kontekste/ rrethana shtetore, me traditat e tyre, me kulturat tyre, me institucionet e tyre, me ligjet e tyre, etj. Keto shtete perfaqesojne fusha e kuadre, brenda te cilave qytetaret diskutojne, rrahin mendimet, ballafaqojne konceptimet e tyre mbi te drejten e qytetarise, pushtetin, arsimin, bashkejetesen etj . Studimi dhe nxitja e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise ne Evrope dhe pertej mjeteve, te cilat jane te hapura ndaj ndryshimeve ne kontekstet/ rrethanat mes shteteve si dhe ndaj dallimeve brendaperbrenda seciles prej tyre, krijohet shkeputje nga reflekse dhe stereotipe, qe i bejne njerezit t’u atribojne karaktere te vecanta dhe konceptime te vecanta te gjithe qytetareve te nje shteti te dhene, kurse ne hapsirat tona demokratike ne, aktualisht, ndajme shume referenca, shqetsime dhe debate;
- Kontekstet/rrethanat lokale, duhet patur parasysh se termi “lokal” mund te perdoret per zona me permasa dhe konfiguracione nga me te ndryshmet, duke filluar me fqinjat ose fshatrat e deri tek nje rajon i caktuar, kontekste keto te percaktuara nga kufije administrative apo kritere te tjera, kontekste lokale, ne te cilat qytetaret veprojne ngushtesisht per ceshtjen e integritimit social dhe territorial;
- Kontekste me te pergjithshme te lidhura me fenomenin e globalizmit dhe qe kane te bejne me proceset dhe tendencat qe perfshijne si realitetet lokale edhe ato shtetore.

Ky dallim midis konteksteve të ndryshme sipas territorit ka nevojë të plotësohet, duke menduar në kuadrin e rrjeteve të ndryshme. Në botën e sotme ekzistojnë shumë fenomene ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat zhvillohen si rrjete/ sisteme të caktuara, psh në përputhje me sistemin e marrëdhënieve, që injorojnë kufijtë, vecanërisht ato politike dhe administrative.

Në këtë raport në nuk mund t'i paraqesim të gjitha studimet e Keshillit të Evropës, në të cilat diskutohet për këto kontekste dhe ku, në të njëjtën kohë, behen përpjekje për të vendosur marrëdhënie mes tyre, për të nxjerrë në pah karakteristikat e tyre specifike, për të identifikuar dinamikën e tyre dhe për të parashikuar tendencat e së ardhmes së tyre. Në do të kufizohemi në diskutimin e tri prej temave të studiuara, të cilat përfaqësojnë shembuj të vecantë mbi rëndësinë që ka konteksti si përsa i përket refleksionit ashtu edhe vënies në praktike të Edukimit të së Drejtës Demokratike të Qytetarisë.

**Kulturat dhe menyrat e jetesës së të rinjve** kanë qenë objekt i një studimi të thellë. Format tradicionale të pjesëmarrjes politike dhe sociale, si menyra për t'u përshatur në shoqëri dhe për të vendosur marrëdhënie me të tjerët, janë braktisur në favor të grupimeve të bazuara në "nen-kulturat", ku parashtesa "nen" nënkupton një kategori specifike brenda së tërës, e cila njihet si "kultura rinore" dhe jo një gjykim me vlerë. Disa komentatorë i interpretojnë këto "nen-kultura" si menyra për të kundërshtuar kulturën dominuese/mbizotëruese dhe për të krijuar të tjera si këto, përmes menyrave të jetesës ku veshja, muzika dhe aktivitetet e kohës së lirë luajnë rolin kryesor ose, bile, të vetëm në krijimin e një identiteti dhe si proces shoqërizimi. Këto metoda funksionojnë jashtë institucioneve tradicionale të familjes dhe të shkollës. Shumë studiues i analizojnë këto nen-kultura si instrumenta adoptimi/përshatjeje ndaj ndryshimeve sociale. Ndjenja e të jetuarit në një botë në ndryshim të vazhdueshëm nxjerr në pah një lloj "enrgjije/force" të përhershme/permanente. Në shumë manifestime, e rëndësishme është, para së gjithash, pjesëmarrja në një ngjarjen që ndodh, një ngjarje kjo, që ekziston vetëm përmes dhe me anë të kesaj pjesëmarrjeje. Ndërsa disa komentatorë vënë theksin në aftësinë e këtyre nen-kulturave rinore për të vënë në pikepyetje kontrollin ndaj industrive kulturore komerciale, të tjera e vënë theksin në peshën mbisunduese dhe në fuqinë riaftësuese të këtyre industrive. Interpretimi i këtyre levizjeve lidhur me të drejtën e qytetarisë është vecanërisht delikat. Ndërsa aspekti kreativ/krijues dhe identifikues, që krijon identitete fleksible e të levizshme është, pa dyshim, tepër i hershëm, ose edhe i vetmi, dhe rëndësia që lidhet me të tashmen, me kënaqësinë që ndihet në këtë aktualitet, parandalon marrjen në konsideratë të çështjeve që kerkohen nga shoqëritë tona dhe që kerkojnë një përfshirje të qëndrueshme të të gjithë qytetarëve. Kur shfaqet një shprehje politike me e drejtëpërdrejtë, ajo fokusohet në një çështje të vetme dhe i konsideron problemet në mënyrë tepër fragmentare. Rëndësi sociale dhe skepticizmi i mundshëm lidhur me të, sigurisht, që nuk janë shqetësimi kryesor i këtyre nen-kulturave.

Studimet mbi **policinë dhe të drejtat e njeriut** janë emblematike për veprime, të cilat janë të nevojshme për zotëruarit e autoritetit publik të çfarëdo lloji. Të kryera, kryesisht, nga sektori i të Drejtave të Njeriut pranë Keshillit të Evropës, këto studime vënë theksin në rëndësinë që ka në çdo shoqëri demokratike, një forcë policore cilesore, e përbërë

nga njerez te cilet i njohin plotesisht te drejtat e njeriut, cka perben nje garanci ndaj rrezikut te korrupsionit. Sherbimi policor eshte nje sherbim publik, nje sherbim per qytetaret dhe per te gjitha njerezit : detyra e tij eshte mbrojtja. Nuk eshte detyra e policise te denoje kundravajtesit ( shkelsit e ligjit), por kjo eshte detyra e sistemit juridik. Mbrojtje do te thote, gjithashtu, mbeshtetje e lirive te gjithesecilit ne menyre te tille qe shoqeria civile te mund te jete nje vend ku lindin iniciativa dhe ku gjithsecili pranon pergjegjesite e veta. Kjo kerkese eshte vecanerisht aktuale ne vendet, te cilat i kane ngritur se fundi institucionet e tyre politike demokratike. Sjellja dhe qendrimet e policise jane me te rendesishme ne rastet kur kjo konsiston ne nje manifestim me te dukshem te fuqise publike. Si me te gjitha fushat e tjera te punes qe ka hapur, Keshilli i Evropes eshte nje vend per shkembime eksperiencash dhe dialog mbi kete teme, ku zyrtare, aktore dhe studiues te ndryshem pershkruajne eksperiencat e tyre ne zhvillimin e nje force policore demokratike. Sikurse me shume fusha studimi te ceshtjeve sociale, edhe ketu analizat konvergojne ne afirmimin e rolit vendimtar qe luhet nga kualifikimi, qofte ky kualifikim baze apo kualifikim ne sherbim/ ne marredhenie pune. Kjo lidhet me shume me punen qe ka te beje me qendrimin dhe sjelljen e policise ndaj personave te tjere sesa me punen qe duhet bere lidhur me te drejtat e policit brendaprebrenda institucioneve policore. Shkelja e te drejtave te njeriut konstatohet ne trajtimin qe policia i ben njerezve te tjere si dhe ne menyren sesi ata e trajtojne njeri tjetrin. Studimet mbi policine tregojne gjithashtu se te drejtat e njeriut dhe e drejta demokratike e qytetarise jane pergjegjesi e institucioneve , vecanerisht e institucioneve publike dhe jo vetem e individeve.

Tema e trete qe po diskutojme eshte me gjithepershires. Ajo lidhet me marredheniet e njohura mes **shtetit, shoqerise civile dhe tregut**, per te cilat flitet gjithashtu edhe si **shoqeria e tregut, demokracia, e drejta e qytetarise dhe solidariteti**. A perputhen keto plotesisht me njera tjetren ? Pergjigjja, me sa duket, eshte teper komplekse dhe kapercen kufijte e ketij raporti te konsoliduar. Pikepamjet mbi kete ceshtje divergojne, ose jane, ne te vertete, diametralisht te kunderta. Disa popuj e shohin shoqerine civile si forumin kryesor per iniciativa e liri, ne nje shtet me nje trupe te tere ndihmese, te cilit, kurdohere qe eshte e nevojshme, i krijohet nje hapshire minimale per veprim : drejtesia, policia, ushtria dhe diplomacia jane fushat e vetme, ku eshte e domosdoshme te nderhyet. “ Interesi i pergjithshem “, persa kohe qe kjo ide ka nje kuptim , eshte rezultat i natyrshem i shtrirjes se interesave specifike te aktoreve qe gezojne liri maksimale. Ekstremi i kundert eshte nje konfiguracion i cili perqendrohet ne rendesine qe ka nje autoritet publik i fuqishem ne garantimin e “ interesit te pergjithshem”, i cili, nga ana e tij, ndertohet dhe debatohet ne nje ambient vendim-marres te barabarte, te percaktuar nga e drejta demokratike e qytetarise. Keto dy ekstreme takohen/ ndeshen rralle ne nje forme kaq te qarte dhe shoqerite tona demokratike pergjithesisht zene pozicione te ndermjetme te ndryshme. Megjithate, veshtiresite me te cilat perballen shtetet, vecanerisht shtetet e Mireqenies si dhe transformimet aktuale kane bere qe konceptimet e meparshme te behen gjithnje e me atraktive/terheqese. Avokatet e tij e interpretojne krizen e kohezionit social si nje deshtim te shtetit te Mireqenies, dhe, ne perputhje me kete, propozojne nje hapshire maksimale per shoqerine civile, e cila cilesohet si “ shoqeri e tregut”.

Mbeshtetësit e konceptimit të fundit e shohin këtë krizë si rezultat të ndryshimeve, të cilat ose janë nën kontroll ose të pakten janë shkaqe potenciale të përjashtimit dhe të përçarjeve sociale. Ky debat mund të vazhdojë, pasi ai ve në diskutim mënyrën sesi në i kuptojmë dhe analizojmë vështirësitë aktuale dhe po kështu edhe përcaktimin që në i bëjmë veprimeve të përshtatshme, përfshi këtu edukimin për të drejtën demokratike të qytetarëve.

Pavaresisht nga e ardhmja e këtyre diskutimeve, nëse i kombinojmë termat e sipërpermendur në një mënyrë sa më të natyreshme që të jete e mundur, termat, apo me saktë realitetet që ato mbulojnë, nuk janë kaq solide sa duken. Psh, hendeuku në të ardhura thellohet, duke bërë që të pasurit, si individë apo si shtete, të pasurohen gjithnjë e më shumë dhe të varferit të varferohen gjithnjë e më shumë. Ndermarrjet e mëdha shumëkombëshe dhe ato transnacionale si dhe institucionet ekonomike janë në mënyrë të konsiderueshme me të fuqishme sesa shumica e shteteve; raporti i fundit i PNUD-it tregon se pasuria e 200 personave me të pasur në botë i kalon të ardhurat e përgjithshme të një grupi shtetesh ku jetojnë 41% e numrit të përgjithshëm të popullsisë së botës ( 2.3 miliardë njerëz). Disa oratore në konferencën e Parlamentareve dhe të NGO-ve ( organizatave joqeveritare) theksuan se për shumë vite qeveritë, veçanërisht në Evropë, kanë punuar kryesisht në favor të një integrimi me të madh të ekonomive kombëtare në tregun botëror, duke cuar në shkeljen e sovranitetit, dhe jo në favor të institucioneve demokratike nën-apo-mbikombëtare, por në interes të atyre ndermarrjeve dhe institucioneve, të cilat nuk janë aspak demokratike. Ekziston një tendencë e fortë drejt një krize zhgënjimi me politiken dhe nderkohe vihet në pikepyetje fuqia e shteteve, veçanërisht dimensionit i shtetit të Mireqenies si dhe aftësia e shoqërisë civile për të ndermarre iniciativë, të cilat janë të nevojshme për të rruajtur e zhvilluar lidhjet sociale. Është disi paradoksale të shprehësh shqetësim mbi demokracinë e pamjaftueshme, dhe në të njëjtën kohë të pranosh shkatërrimin dhe demtimin e institucioneve politike demokratike në favor të një levizjeje ( pak a shumë koherente) të iniciativave sociale, legjitimiteti i të cilave afirmohet nga fakti i thjeshtë i ekzistencës së tyre. Format politike demokratike duhet të evoluojnë e të ndryshojnë, por “ kthimin “ e qytetarit, apelin e nevojshëm për të drejtën qytetare në ndermarrjen e iniciativë dhe marrjen përsiper të përgjegjësisë nuk duhet ta konsiderojmë si rezultat të mirë të krizës së shtetit dhe të institucioneve politike demokratike. Kështu, psh nuk ka arsye që tregu, njerëzit dhe institucionet që e dominojnë atë, të vendosin në favor të interesit të përgjithshëm. A është tregu një nder vendet , apo vendi ku prodhohet në interes të përgjithshëm? A është efektifiteti ekonomik, sipas parimeve të një ekonomie tregu të lirë tepër liberale, një rrugë apo rruga për të garantuar interesin e përgjithshëm, për ta përcaktuar apo realizuar atë? Cështja e interesit të përgjithshëm është e një natyre politike, çka kërkon një diskutim mes të gjithë qytetarëve dhe që kërkon institucione, të cilat garantojnë respekt për parimet e demokracisë e të të drejtave të njeriut , veçanërisht barazi dhe liri . Kështu, shoqëria civile nuk mund të ekzistojë në mënyrë demokratike pa institucionet publike demokratike, dmth pa institucione, të cilat kontrollohen nga të gjithë qytetarët , institucione që garantojnë liritë themelore si dhe barazi në mundësitë që u krijohen të gjithëve për të përfituar nga të mirat publike, pavaresisht nëse kjo ka të bëjë me të drejtat të tilla si psh arsimi apo shërbimi mjekësor apo drejtësia. Dhe anasjelltas, shoqëria civile mban përgjegjësi për të nxitur dhe organizuar debatin demokratik, për të identifikuar

dhe diskutuar mbi ceshtje shoqerore te medha e te vogla, per te cilat qytetaret jane pergjegjes. Dhe se fundi, tema e fundit per diskutim eshte drejtesia me shume ne kuptimin etik sesa ne ate institucional. Kjo ceshtje po rishtrohet ne kuadrin e nje game te gjere projektesh kerkimore ne fushat e shkencave filozofike dhe politike. Ajo perfshin nje menyre specifike lidhur me ceshtjen e te kuptuarit te jetes komunale, te bashkeekzistences dhe te objektivit/synimit te nevojshem te cdo shoqerie. Ne do te rikthehemi serisht tek kjo ceshtje me vone, kur te flasim per pergjegjesite.

### **3.QYTETARI, E DREJTA E QYTETARISE : THELBI, VARIACIONET DHE SFIDAT KONCEPTUALE**

Per sa me poshte vijon, do te parashtrojme thelbin e koncepteve mbi qytetarin dhe te drejten e qytetarise si dhe variacionet e pyetjet, objekt i te cilave eshte vete ky thelb. Duke patur parasysh ndryshimet e shpejta qe po ndodhin ne shoqerite tona dhe se bashku me to edhe menytrat sesi ka lindur dhe eshte perjetuar e drejta e qytetarise, eshte esenciale te riafirmojme se cfare eshte thelbesore ne konceptimin e se drejtes se qytetarise ne nje shoqeri demokratike. Kjo do te na lejonte te shmangnim emertimin “ qytetare” per cdo iniciative, sjelljeje apo qendrimi persa kohe qe lidhur me kete merren ne konsiderate te tjeret. Te gjitha shoqerite kane hartuar dhe zbatojne rregulla te jetes kolektive, metoda te zgjidhjes se konflikteve, menyra te bashkejetuarit me te tjeret, si me te tjere brenda se njejtës shoqeri ashtu dhe me te tjere jashte saj, me ata , te cileve nuk u perkasin. Ku qendron e vecanta lidhur me referencen ndaj te drejtes demokratike te qytetarise ? Cfare nenkupton kjo reference per individet dhe institucionet, cfardo qofshin ato ? Nje fjale ose nje reference, e cila shenderohet ne dicka te vaget e te mjergullt nuk mund te perdoret me per te ndihmuar ne konceptimin ose drejtimin e veprimit, por sherben thjeshte per te sjelle nje lloj konsensusi te shtruar, me te cilin gjithkush mund te shkoje perpara sepse askush nuk ka saktifikuar dicka vitale.

Si per te gjitha termat e perdorura kur flasim per jeten sociale dhe politike, edhe termi “ e drejta e qytetarise” eshte larg te pasurit nje kuptim te qendrushem e pergjithesisht te pranueshem. Po behet gjithnje e me i njohur fakti se kemi te bejme me nje “ koncept shumeformesh ”<sup>3</sup>. Eshte e qarte se nje gje e tille ka pasoja te rëndesishme per kompetencat thelbesore te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise. Kjo eshte nje situatë plotesisht normale dhe legjitime. Edhe kur perpiqen te mos jene ne kontradike me parimet, te pranuarat zakonisht lidhur me percaktimin e nje shoqerie demokratike, institucionet tona politike dhe sociale u pershtaten traditave te ndryshme dhe marrin forma te shumta. Per me teper, kuptimet e termit

“ e drejte qytetare” jane te hapura ndaj eksperiencave te reja qe vete jeta, ne menyre te vazhdueshme, na ben te zbulojme, ndaj formave te reja qe e drejta e qytetarise dhe jeta politike demokratike do te marre ne te ardhmen. Per kete arsye eshte normale dhe bile edhe e deshirueshme qe kjo terminologji te ndryshoje. Fjalet e perdorura ne secilen gjuhe jane deshmi e ketij diversiteti.

---

3. Zoti Ernst Jouthe, nen ministry per ceshtjet sociale te Kebekut flet mbi nje “ koncept polisemik dhe te kontestuar” Seminari me teme : “Konceptet baze dhe kompetencat thelbesore “ dokumenti i vitit 1997 DECS/CIT ( 98),shitesa 7.

Ato janë instrumentat me të cilat çdo kulturë, përmes përdorimit, krijojnë dhe shprehin konceptimin e tij ose të saj mbi jetën politike e sociale, mbi lirinë dhe marrëdhëniet me të tjerët. Kjo është bërë çdo përpjekje, me baze sintetike, vëcanërisht të vështira, pasi çdo përpjekje e tillë do të vihej në dyshim nga reduktimi i diversitetit të eksperiencave dhe mënyra e të menduarit dhe po kështu edhe nga standardizimi kërcënues, një kërcënim real ose i imagjinuar tepër prezent në shumë fjalime dhe në shumë imagjinata individuale dhe kolektive. Këtu e gjejmë veten vazhdimisht mes afirmimit të identiteteve kolektive, që bazohen në konceptimet e ndryshme politike, të cilat zhvillohen në kuadrin e Shteteve të njohura sot në botë dhe kërkimit të elementeve të përgjithshëm për krijimin e një Evropë demokratike e të një hapësire Evropiane të lirise, barazise dhe solidaritetit. Kjo hapësire Evropiane ka shumë dimensione dhe aspekte komplekse, të cilat, dukshëm, nuk kufizohen vetëm në kuadrin e universitetit politik, edhe pse kërkohet gjithnjë ekzaminimi i kushteve legale dhe politike për ushtrimin e lirisë dhe mbrojtjen e të drejtave.

Një vështrim i shpejtë në fjalorë të 5 gjuhëve të ndryshme<sup>4</sup> është me vend këtu. Ai hedh dritë mbi nuancat dhe bile mbi dallimet, që janë të pranishme në tekstet baze të këtij studimi, të hartuar nga autorë të shteteve të ndryshme, e po kështu mbi bazën e kulturave të ndryshme politike dhe juridike/ ligjore. Secili nga këta autorë shprehet brenda kuadrit të vet kulturor, bile edhe kur merr parasysh, sa me shumë të jete e mundur, shumëllojshmërinë e pikepamjeve të shprehura në takimet e punës së Këshillit të Evropës<sup>5</sup>.

Anglisht: **qytetar**.....**1** person që jeton në qytet, jo në fshat: qytetaret e Parisit. **2** person që gëzon të drejtat e plotë në një shtet, ose në një shtet që është vendi i lindjes së tij, ose duke siguruar të tilla të drejta: emigrantet që janë bërë qytetare të Shteteve të Bashkuara. Krahaso subjekt britanik; qytetar i botes, person kozmopolitan. **Qytetari/ e drejte qytatarie**.... të qenit qytetar; të drejtat dhe detyrat e një qytetari.

Gjermanisht: **qytetar** (...) banor i një qyteti apo i një shteti (nenshtetas); anëtarë i shtresës së tretë shoqërore, të borgjezisë trashëgimtare, borgjez; civil; një civil/qytetar i Shteteve të Bashkuara; një akademik -anëtar i një shkollë të mesme; një qytetar i nderuar i qytetit tone (zu Burg)

**Borgjez** (...) përfaqësues i borgjezisë, joaristokrat

<sup>4</sup> Zgjedhja e këtyre 5 gjuhëve u përcaktua nga aftësia e autorit të këtij studimi për të kuptuar përcaktimet e përfshira në fjalorët korrespondues.

<sup>5</sup> Kjo është një çështje delicate. Nderkohe që gjithkush shprehet në kontekstin e kulturës së ciles ai/ ajo i përket, kjo kulturë nuk është as homogjene dhe as e mbyllur. Në çdo vend evropian zhvillohen debate, shpeshherë mjaft të nxehta, në të cilat vihen në pikepamje konceptimet mbi jetën social –politike. Dhe së fundi, askush “nuk përfaqëson” një kulturë dhe asnjë kulturë nuk përfaqësohet nga një person i vetëm.

Spanjisht : **qytetaria/shtetesia**. 1 cilesi e qytetarit te nje vendi te caktuar. O te drejtat e qytetarit te nje vendi te caktuar.( V. “KOMBESI, ORIGJINE” ) 2. “ Civilizim”.Sjellje e vecante e nje qytetari te mire: ‘Duhet votuar per qytetari’.

**Qytetar( mbiemer)** 1. me origjine ose banor i nje qyteti te caktuar, 2. aplikohet per personat e nje qyteti te vjeter apo te nje shteti modern me te drejtat dhe detyrat qe kerkon kjo gje; per shkak te ketyre te drejtave dhe detyrimeve kjo fjale permban ose fiton, me ane te mbiemrave, nje vleresim moral dhe nje permbajtje afektive:‘Nuk eshte qytetar/shtetas i mire ai qe nuk respekton ligjet. Ndihet si qytetar/ shtetas i botes’.( V.” me origjine, nenshtetas.> patric, republikan.

> Civilizim, vlere civilizuese> te marresh shtetesine, te behesh origjinal > I lire> bashkeqytetar.”) 3. Ne kohet e vjetra, \* banor i qytetit, qe i perket klases se ndermjetme midis “zoterinjeve” dhe “artizaneve/ punetoreve”. 4.” Njeri i mire”. Njeri i qete.

Italisht :**Qytetari** , 1. Banoret e nje qyteti ; qytetaret jane ftuar ne kremtimet Danteske. 2.perkatesia e vecante ne nje shoqeri, organizate ose shtet ; shtetesi e lindur ; shtetesi e fituar / shtetesi e vogel, e privuar nga te drejtat politike dhe detyrimet ne sherbimin ushtarak / nenshtetesi e dyfishte , perkatesi e vecante , ne cilesine e qytetarit ne dy shtete.

Frengjisht: **Qytetar/qytetare...** ( XVI , “bashkeqytetaret” ; ... te nje qyteti. 1. antonim i fshatarit. Banor i nje qyteti... 2. ( deri ne shek XVII). Ne antikitet. Qe i takon nje qyteti (2) , i afte per te gezuar ne territorin e vet te drejten e banimit... 3 (XVIII) Ne kohet moderne. Nje individ i konsideruar si person civil vecanerisht ne nje shtet qe quhet republike... 4 (XVII) Nje qytetar i botes, i cili vendos interesin e njerezimit mbi interesat kombetare. **Qytetari/civilizim/** : ... Cilesite e qytetarit. Qytetaria/civilizimi francez.

### 3.1 Thelbi

Pavaresisht nga ndryshimet brendapërbrenda çdo përcaktimi dhe midis gjuhëve, ekzistojnë disa pika të përbashkëta, të cilat sigurojnë, megjithatë, një bazë të shëndoshe për ta zbuluar të drejtën e qytetarisë. Në këtë mënyrë kemi të bëjmë gjithnjë me ceshtjen e perkatesisë ndaj një komuniteti, që i jep drejtim politikës dhe të drejtave, vecanërisht të drejtave politike. Në këtë kuptim, qytetari është gjithnjë një bashkë-qytetar, një individ që jeton me të tjerët. Ky komunitet perkufizohet në mënyrë thelbësore në dy nivele: nga njëra anë në nivelin lokal, të qytetit, shpesh në kuptimin urban, ku jeton individ, dhe ku i takon të jetojë dhe nga ana tjetër në atë shtetëror, që lidhet me të qenit një shtet kombëtar<sup>6</sup>, i cili siguron të drejtat e plotë për anëtarët e këtij shteti. Kjo perkatesi i referohet gjithnjë nivelit të organizimit politik, nivelit të një autoriteti dhe të drejtave; me fjale të tjera, qytetari dhe e drejta e qytetarisë kanë të bëjnë gjithnjë me përvijimin e një territori a të një grupi, të një territori ku të drejtat janë të zbatueshme, dhe të një grupi, ku të gjithë njerezit i gëzojnë këto të drejta; kështu ata janë të prirë, para se gjithash, ndaj fushave politike dhe legale. Dhe së fundi, në varësi me traditën, theksi bie me shumë në nivelin lokal si niveli i parë i perkatesisë dhe si hapësirë e kufizuar në mënyrë të krenaqshme e ku individit e ka me të lehtë të jete aktiv e pjesëmarrës, ose në nivelin Shtet-kombëtar si niveli kryesor, ku vendoset ligji dhe ku krijohet identiteti publik kolektiv. Në asnjë shtet nuk mund të përjashtohet njëri apo tjetri nivel: me shumë, kemi të bëjmë me një ceshtje që lidhet me prioritetin që i kushtohet njërit apo tjetrit nivel, një zgjedhje kjo, që ka pasoja lidhur me konceptimet për Edukimin mbi të Drejtën Demokratike të Qytetarisë.

Kjo mund të duket paradoksale në kohën kur pushteti politik, vecanërisht ai i shteteve, po vihet në pikepyetje nga zhvillimi i entiteteve të mëdha ekonomike shumëkombëshe dhe i ndërmarrjeve të mëdha multinacionale, transnacionale dhe ,bile edhe, mbinationale. Kjo është gjithashtu paradoksale, në kohën kur po rriten pretendimet për të drejtat e vecanta dhe kur po debatohet mbi mundësitë për zgjerimin e masave që synojnë njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të vecanta të individëve e të grupeve.

Megjithatë ky studim nuk është ende i plotë. Ai duhet të pasurohet me idene se qytetari dhe e drejta e qytetarisë ekzistojnë në hapësirat demokratike, dmth. në hapësira, ku individët gëzojnë të drejtat e barabarta dhe dinjitet, ku ligji behet nga njerezit dhe për njerezit. Barazia ligjore dhe politike, së bashku me parimin e mosdiskriminimit kombinohet me një zgjerim maksimal të lirive. **Qytetari është një individ, i cili ka të drejta dhe detyra, në një shoqëri demokratike.** E drejta e parë është ajo e vendosjes së ligjit; detyra e parë është ajo e respektimit të ligjit dmth. ushtrimi i lirive të tij, zhvillimi i iniciativave të tij, organizimi i marrëdhënieve të tij me të tjerët brendapërbrenda kuadrin të përcaktuar nga ligji.

---

<sup>6</sup> Shtet, komb, shtet-komb..... këto koncepte kërkojnë një analizë që e kapërcen hapsirën e këtij studimi. Kështu kombi lidhet me konceptime të ndryshme jo vetëm të marrëveshjes sociale ose politike por edhe të asaj kulturore e të kulturave, të gjuhës e të gjuhëve, të mundësisë së perkatesisë etj. Për më tepër, do të ishte e nevojshme të vendosej në një kontekst historik si ideja e shtetit komb ashtu edhe format specifike që ka marrë ai në shtete të ndryshme Evropiane, në mënyrë që ta shqyrtojmë atë si konstrukcion historik, të krijuar në një moment specifik, në një kontekst specifik dhe që nuk paragjykon forma të tjera politike që mund të shfaqen në të ardhmen.

E drejta demokratike e qytetarise nenkupton, ne kete menyre, autonomine e individit si vlere primare, me gjithë rreziqet qe mund ta shoqerojne kete; per me teper, shume diskutime e veprime perkatese perpiqen te bejne nje lloj moderacioni te kesaj autonomie- lirie duke i bere thirrje ndjenjes se pergjegjesise dhe njohjes se detyrimeve legale dhe atyre morale, te cilat kushtezohen nga bashkejetesa me te tjeret dhe nga respekti per persona te tjere apo grupe te tjera.

**Keshtu, kompetencat thelbësore te lidhura me te drejten demokratike te qytetarise jane ato qe kerkojne, formimin e nje individi te lire dhe autonom, te ndergjegjshem per te drejttat dhe detyrat e tij ne nje shoqeri , ku ushtrohet force per vendosjen e ligjit, dmth. te rregullave te jetes komunitare, te cilat percaktojne kuadrin, ku gjithkush ushtron lirine e tij/saj, dhe ku emerimi e kontrolli ndaj njerezve te pushtetit behet nen mbikqyrjen e gjithë qytetareve.**

Ketu, njohim tashme parimin e pare te te drejtave te njeriut, qe eshte - “ Te gjitha qeniet njerezore lindin te lira e te barabarta ne dinjitet e ne te drejta”- si dhe pasojat e tij ne nje shoqeri demokratike, qe lidhet mjaft ngushte me te. Ne te gjitha nivelet, autoriteti publik eshte burim per qytetaret, ne interes te qytetareve, dhe kontrollohet nga qytetaret. Aksesi/ mundesite per te mirat komunale- sic jane shkollimi, sherbimi shendetesor dhe puna- i nenshtrohen, teorikisht, rregullave te barazise. Kriza politike ne demokracite tona eshte, ne kete menyre, nje krize ne perpjekjet per barazi perballe tendencave drejt fragmentarizimit dhe pushtetit ne rritje te forcave te medha ekonomike. Dhe se fundi, duhet vene ne dukje se, te drejttat qendrojne mbi te gjitha lirite, ne aftesite per te vepruar dhe jo per te imponuar detyrime qe sigurohen ne menyre pasive.

Theksi mbi “ thelbin “ e se drejtes se qytetarise nuk i eklipson aspektet e tjera – ato ekonomike, sociale dhe kulturore- te se drejtes se qytetarise. Prej shume kohesh e drejta e qytetarise lidhej vetem me sferen politike dhe me vone, vetem, me aktin e votimit: deklarimi dhe ekzistenca e te drejtave ekonomike dhe sociale ka qene, per nje fare kohe, objekt debati lidhur me te drejttat e njeriut. Pa dashur te rideklorojme interpretimin, e sygjeruar nga Marshall, eshte e rendesishme te pohojme natyren plotesuese te te drejtave civile dhe politike dhe te te drejtave ekonomike dhe sociale. Eshte jetike te krijohen kushte materiale minimale per mbijetese si dhe mundesi per te siguruar disa te mira “ esenciale”, nese te drejttat dhe lirite politike te garantuara per te gjithë nuk do te shumezoheshin me zero; ne te kundert, percaktimi i te drejtave ekonomike dhe sociale dhe i kushteve per te pasur akses per to, mund te jete rezultat vetem i nje debati demokratik, te mbeshtetur nga te drejttat civile dhe politike. Larg te qenit te kunderta, keto dy kategori te drejtash mbeshtetin njera tjetren. Te drejttat ekonomike dhe sociale kane dukshem nje dimension legal. Ceshtjes se te drejtave kulturore do t’i drejtohem i ne nje faze te mevonshme, pasi vazhdojne te mbeten objekt diskutimesh dhe nuk jane percaktuar ende tamam. Ne do t’i drejtohem i ceshtjes se te drejtave kulturore ne nje etape te mevonshme, meqenese keto te drjta nuk kane mundur te sigurohen ende, e jo me te jene stabilizuar , dhe se ato jane te rrethuara ende nga polemikat.

Perkundrajt ketij sfondi, Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise perfaqeson projektin per edukim dhe kualifikim, ne te cilin ka tensione, ambivalenca dhe bile edhe

kontradikta të mëdha. Qëllimi i tij nuk është as teknik e as profesional. Ai ka të bëjë me individin dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët, me krijimin e identiteteve personale dhe kolektive, me kushtet e bashkëjetesës. Në këto mënyra ai ka të bëjë me individin dhe shoqërinë, me të vecantën dhe universalën, me shtesën në një vazhdimësi historike e kulturore, dhe me zbulimin e së ardhmes, me ndërtimin e një bote të ardhme, me pranimin e një realiteti paraekzistues dhe me zhvillimin e një metode kritike.

**Te gjithë qytetarët e shteteve demokratike janë prodhues dhe konsumues të edukimit për të drejtën demokratike të qytetarëve.**

Kjo metodë përcakton qëllimin kryesor të Edukimit për të Drejtën Demokratike të Qytetarëve. Në këto faza, mund të bëjmë dallimin mes:

- përcaktimit politik dhe ligjor të së drejtës demokratike të qytetarëve, të lidhur me statusin që gëzojnë të gjithë ata, të cilët, me të drejtë, i përkasin një komuniteti publik; kështu, ndërsa e drejta e qytetarëve mbështetet mbi këto përkatesi, nuk duhet harruar se edhe të huajt gëzojnë shumë të drejta, përfshi këtu shumë të drejta social-ekonomike;
- kompetencave që dëshirohen apo priten të sigurohen, që kërkohen apo enderohen të realizohen, në mënyra që marrja parasysh e këtij statusi dhe e kesaj jetese si dhe e të drejtave dhe detyrave të lidhura me të, të lejojë rruajtjen dhe zhvillimin e saj drejt një lirie, barazie dhe demokracie me të madhe.

### **3.2 Variacionet dhe sfidat konceptuale**

Përveç koncepteve themelore të lidhura, kryesisht, me dimensionin politik dhe legal të së drejtës demokratike të qytetarëve dhe me të drejtat e njeriut si psh me- barazinë, lirinë, dinjitetin, të drejtën, ligjin, pushtetin etj., - është e nevojshme t'i atribuojmë një vend të vecantë disa metodave dhe fushave relativisht të reja, të cilat janë të pasura dhe të diskutueshme.

Në rradhë të parë, duhet të marrim në konsideratë të gjithë mbiemrat/ cilesoret që përdorin njerezit së bashku me termin e drejta qytetare. Larg të qenit shembuj sterhollimesh linguistike, këto mbiemra japin, pak a shumë, kuptime ekzakte. E para prej tyre është, natyrisht mbiemri “demokratik”. Për Keshillin e Evropës, ky mbemër thekson faktin se kemi të bëjmë me një të drejtë qytetare që mbështetet mbi parimet dhe vlerat e pluralizmit, mbi epersinë e ligjit, respektin për dinjitetin njerezor dhe diversitetin kulturor, si pasurim. Mbiemra të tjera, si psh “pluralist”, “i hapur”, “me eksperience” etj. shprehin refuzimin për t'u kufizuar në një koncept të vetëm, të prerë dhe tingellojnë si thirrje e grumbulluar për të shumefishuar përpjekjet e arsyeshme për të krijuar kuptimin e të drejtës demokratike të qytetarëve dhe zbuluar vazhdimisht format e reja që merr ajo.

Kështu, konceptet e pjesëmarrjes, të demokracisë ose të së drejtës së qytetarëve duket se po njihen gjithnjë e më shumë si tepër të rëndësishme për të ardhmen e bashkëjetesës sonë.

Kjo eshte nje ceshtje qe garanton se gjithkush mund te zere vendin e vet ne shoqeri dhe te kontribuojne ne zhvillimin e saj, ne cfardo lloj nivli qofte, pertej veprimit politik te votimit. Kjo ceshtje ka te beje me aftesine e gjithsecilit per te vendosur kontroll mbi ambientin e vet te jeteses. Reduktimi i pengesave per pjesemarrje, vecanerisht i pengesave social-ekonomike, eshte pjese perberese e cdo strategjie qe synon forcimin e te drejtes demokratike te qytetarise.

Ne plan te dyte per Edukimin me te Drejten Demokratike te Qytetarise vjen gjithcka qe lidhet me institucionet arsimore dhe te kualifikimit. Berja e nje inventari, qofte edhe shume i paplote, do te perfaqesonte nje liste shume te gjate per kete dokument. Megjithate, nese Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise perben nje shqetesim te vazhdueshem te te gjithe qytetareve dhe te te gjitha institucioneve te nje shoqerie demokratike, eshte fakt se ai ka dhe duhet te kete nje prezence eksplicite (te qarte) dhe prioritare ne institucionet e arsimit e te kualifikimit, dhe vecanerisht ne shkolla. **Kooperimi, pjesemarrja, dialogu dhe respekti perfaqesojne kaq shume fjale, te cilat shprehin qendrimet qe priten te mbahen nga te gjithë ne shkollë,** vecanerisht nga te riturit, qendrimet qe duhet te frymezojne aktivitetet ne shkolla si dhe atmosferen e pergjithshme ne jeten shkollore.

Se treti, nje fushe e re po zhvillohet vitet e fundit lidhur me ceshtjen e te drejtave kulturore, te cilen, ketu, e lidhim me ate te identiteteve. Shume autore theksojne aktualisht rendesine e marrjes ne konsiderate te identitetit te individit si dicka aktive dhe pluraliste, per te garantuar lirine e perkatesise ne kete apo ate grup, ose ne disa grupe, si dhe lirine e mosperkatesise dhe ate te ndryshimit. Nje komponent esencial i identitetit te individit eshte dukshem komponenti kulturor, duke e vendosur gjuhen dhe gjithcka qe lidhet me te ne vend te pare; kjo ngre menjehere ceshtjen e antaresise se grupeve, komuniteteve, njerzve (keto fjale nuk jane te ngarkuara shume emocionalisht), te cilet krijojne identitetin e cdo individi, vecanerisht te atyre ku rritet individi, e qe perfaqesojne me shume nje trashegimi. Te drejtat kulturore konceptohen, ne kete menyre, si nje gjenerate e re e te drejtave te njeriut, pas te drejtave civile, te drejtave politike dhe te drejtave social-ekonomike. Ndonese, ekziston nje marreveshje mjaft e gjere mbi rendesine e ketyre te drejtave kulturore dhe mbi ate cka i justifikon ato, sic jane respekti per diversitetin e kulturave dhe afirmimi i larmise se shkembimeve dhe hibridizimi, marrja e tyre ne konsiderate ne ngritjen e strukturave politike te shteteve te ndryshme eshte nje problem me delikat.

Te menduarit dhe marrja e vendimeve luhaten midis krijimit te nevojshem te nje hapesire te pergjithshme publike, ku qytetaret ndajne referenca te mjaftueshme per te diskutuar, per te jetuar se bashku dhe per te ndertuar te ardhmen e tyre dhe nje koleksioni te tere konsequencash/pasojash shpresedhenese ose kercenuese, te lidhura me nje afirmim shume te forte te ndryshimeve e te vecorive/ karakteristikave. Nderkohe qe realiteti multikulturor i shoqerive tone pranohet gjeresisht, trajtimi politik dhe legal i ketij realiteti, dmth percaktimi i te drejtave, i te drejtave per personat qe i gezojne ato dhe biles, per me teper, i te drejtave te grupeve qe pergjigjen per to, pa harruar dimensionin territorial te percaktimit te ketij te fundit, diskutohet e krijohet ende dhe do te vazhdoje te

diskutohet e te krijohet. <sup>7</sup> Ciltersia/sinqeriteti ndaj te tjereve eshte nje kompetence thelbesore e se drejtes se qytetarise ( shih me poshte) ; le t'i shtojme asaj, midis te tjerash, realitetin dhe vlerat e hibridizimit , nevojen per t'i hapur vend dimensionit historik dhe kritik, i cili e mundeson ate ne kulturat historike dmth nxjerr ne pah paqendrueshmerine e tyre, linjat e tyre te pushtetit, vazhdimesine e shkembimeve dhe evolucioneve, zbulimin shume te shpeshte te traditave. Ne nuk e dime sesi do te jene kulturat e se nesermes, por per nje gje jemi te sigurte, ato nuk do te jene si kulturat ne kohen e sotme ose si ato qe kane qene dje.

Ceshtja e dimensionit kulturor e te drejtes se qytetarise po shtrohet gjithnje e me shume. Nje nga synimet themelore te edukimit te se drejtes demokratike te qytetarise eshte perforcimi i kultures demokratike. Po keshtu, meqense kuptimi i perkatesise zbehet qarte gjate shprehjes se termat te vlerave qe ndahen, te idenditetit, trashegimise historike dhe kujteses, ajo lidhet gjithashtu pazgjidhmesisht me projektimin e se ardhmes , nje aftesi kjo per te zhvilluar nje projekt kolektiv.

d. Lidhur me idene e nje projekt kolektiv, qe presupozon marredhenie me te tjeret, dmth nje aftesi per te ndermarre iniciativa dhe per te njohur te tjeret, aktualisht po vihet nje theks shume i madh ne konceptin e pergjegjesive. Nje pergjigje ndaj indivializimit dhe fragmentarizimit te shoqerive tona, ndiqet nga kohezioni social dhe nga nje baze e re moral mbi bashkejetesen. Ky nocion, sigurisht, qe ka nevoje te studiohet me tej, pa vene ne pikepyetje parimet e te drejtave te njeriut dhe pa e shenderuar ate ne nje instrument te nje konformiteti te ri social . Psh, theksi mbi pergjegjesine ne nivelin lokal nuk duhet te na beje te neglizhojme format e tjera me te largeta te pergjegjesise, ndikimet e vendimeve lokale ne vende te tjetra dhe impaktin/ndikimin ne situatat lokale te vendimeve te marra diku gjetke. Analiza e pergjegjesise ndihmohet duke u mbeshtetur ne praktiken e edukimit per te drejten demokratike te qytetarise.

Fjala “ pergjegjesi” hap, se paku, dy linja hetimi, ate te ligjit , me idene e pergjegjesise legale, dhe nje fushe me te gjere te aftesise per te njohur te tjeret dhe detyres per t'iu pergjigjur lirise se tyre si persona qe gezojne te drejta. Metoda e fundit ndryshon nga e para dhe e ploteson ate. Ajo ndryshon sepse mbeshtet identifikimin e idese mbi nje rruge plotesuese pergjegjesish <sup>8</sup> per cdo individ dhe eshte plotesuese sepse nuk e mohon rendesine e shoqerise dhe te marredhenieve nderpersonale. Kjo shmang nga njera ane cdo perplasje mes institucioneve publike me marredhenie te bazuara mbi konceptin “ polikisht jokorrekt ” te bindjes dhe, nga ana tjeter, komunitetit ne nje shoqeri te madhe, civile, te painfluencuar nga asnje institucion, e te aprovuar nga publiku, i cili e sheh ate si ambjenti arkitipal per lirine. Nje liri e tille nuk eshte liria e individit te zhveshur nga pushteti, jashte shoqerise, i cili e konsideron shoqerine si nje limit te kompetencave te veta. Liria eshte nje proces i vazhdueshem ndertimi brenda marredhenieve midis individit dhe te tjereve, midis botes dhe vete individit. Institucionet nuk jane pengese, por kuadri i nevojshem human, normative dhe aksiologjik i veprimit. Pergjegjesite lidhen me idete e lirise e te pushtetit, cka i japin konceptit “ shteg “ kuptim te plote.

---

<sup>7</sup> Shiko “ te drejtat kulturore ne Keshillin e Evropes, 1949-1997”,dokumnti DECS/SE/DHRM ( 97) 5.

<sup>8</sup> Shiko Seminari mbi Autoritetin dhe Pergjegjesine: Nga parimi ne Praktike, Delfi ( Greqi),tetor 1999, Dokumenti CDCC/Delfi (99) 4.

## 4. KOMPETENCAT THELBESORE

Ketu eshte hapur nje fushe me te vertete e pakufizuar eksperiencash e qendrimesh, njohjesh e sjelljesh. Shume autore shprehin rezerva persa i perket mundesise dhe, para se gjithash, vleres qe ka hartimi i nje liste. Ata vene ne dukje natyren formale dhe teper jorealiste te nje perpjekjeje te tille. Lista qe do te rezultonte, ne kete rast, do te ishte gjithnje e perkohshme, dhe si e tille nuk do te ishte shume serioze, por e rendesishme eshte fakti se ajo do te perfaqesonte nje varg pergjithesimesh dhe pikash te perbashketa, te njohura nga te gjitha, te cilat te lene te kuptosh se eshte e nevojshme t'i njohesh te gjitha kompetencat qe citohen ne procesin e edukimit. Nje zgjerim pakufi i saj do te kishte efektin pervers te diskretimit te nje liste te tille si dhe te vlerave, parimeve dhe objektive qe perfshihen ne te. Si te shmangim nje litani te gjate kompetencash, shuma e te cilave do te percaktonte perfektionin personal dhe social human, nderkohe qe jeta e perditshme kerkon t'a shfuqizojte ate ( thuajse) ne menyre te vazhdueshme? Keta autore preferojne t'ia kushtojne perpjekjet e tyre studimit te kushteve per nje edukim te tille. Te tjere autore, perkundrazi, mendojne se eshte e nevojshme te perpiqen te vendosin nje fare rregulli ne nje fushe te tille pakufi : per ata, eshte pikerisht natyra jashtzakonisht e gjere dhe vazhdimisht e paqendrueshme e kompetencave te se drejtes se qytetarise ajo qe nenkupton ndermarrjen e nje perpjekjeje per t'i sqaruar dhe klasifikuar ato.

Keto dy metoda nuk jane antagoniste. Konstruktet qe hartojne listen dhe klasifikojne kompetencat nuk mund te zene vendin e veprimit e te nderhyrjes/intervenimit, por ato mund te jene te dobishme per faktin se sjellin nje qartesi te vogel ne kete univers gjithnje te hapur. Ata sigurojne nje kuader teorik, i cili mund te perdoret per te percaktuar, orientuar, nxitur dhe analizuar aktivitetet. Shume klasifikime jane propozuar per raste te ndryshme nga autore te ndryshem, te cilet kane parashtruar menyra te shumta lidhur me planifikimin e edukimit per te drejten e qytetarise. Ne do te theksonim se keto konstrukte/struktura synojne te na ndihmojne, t'i marrim/ pranojme ato si te tilla dhe te perpiqemi t'i permiresojme ato duke i krahasuar / ballafaquar vazhdimisht me realitetin.

### 4.1 Klasifikimi i pare

Klasifikimi i pare perbehet nga tri kategori te medha kompetencash : nga kompetenca njohese, kompetenca emotive/ emocionale dhe nga kompetenca te lidhura me zgjedhjen e vlerave, te lidhura me veprimin. Le te sqarojme pak permbajtjen e seciles nga keto kategori :

- **kompetencat njohese.** Keto kompetenca mund t'i ndajme ne 4 familje.
  - **kompetenca te nje natyre legale e politike,** dmth. njohje e rregullave te jetes kolektive dhe te kushteve demokratike te vendosjes se tyre, njohje e pushteteve ne nje shoqeri demokratike, ne te gjitha nivelet e jetes politike; me fjale te tjera, njohje e institucioneve publike demokratike dhe e rregullave qe drejtojne lirine dhe veprimin, duke kerkuar te kuptohet se keto institucione

dhe lirate jane pergjegjesi e te gjithë qytetareve. Kompetencat legale jane, ne kete menyre, “ armet” me ane te te cilave qytetaret mund te mbrojne lirate e tyre, te mbrojne individet dhe te sfidojne abuzimet me pushtetin nga njerezit ne pushtet ;

- **njohja e botes aktuale**, njohuri qe nenkuptojne , sikurse edhe me siper, nje dimension historik dhe nje dimension kulturor. Eshte fakt se qe te mund te marresh pjese ne debat publik dhe te marresh nje vendim te vlefshem per zgjedhjet e ofruara ne nje shoqeri demokratike, eshte e nevojshme te dihet se perse behet fjale si dhe te kesh disa njohuri mbi objektin/temen e diskutimit. Duke patur parasysh rritjen e fushave te njohurive teorike dhe praktike duhet thene se asnje individ nuk mund te kete kompetenca te plota; nje gje e tille ben qe te dalin probleme te dhimbshme lidhur me perzgjedhjen qe behet ne fushen e arsimit. Keto veshtiresi acarohen nga natyra e perkohshme e nje pjese te mire te ketyre njohurive dhe nga nevoja per t’i mesuar njerezit te pranojne paqendrueshmerine e tyre dhe te perqafojne/ mirepresin ide te reja. Aftesia per t’i bere nje analize kritike shoqerise eshte esenciale. Njohuri te tilla mbi boten e sotme perfshijne gjithashtu aftesite parashikuese, dmth aftesite per t’i pare problemet dhe zgjidhjet ne nje perspektive me afatgjate dhe per te shmangur analizat siperfaqesore afatshkurtra. Ne e dime, por ngandonjehere duket se harrohet, se shume vendime te marra sot do te kene ndikim nesor, pavarsisht nese ato lidhen me rruajtjen e ekuilibrit brenda nje mjedisi formalisht natyror, qe tashme eshte bere plotesisht “ artificial”, duke lene pas energji te mjaftueshme ose burime ushqimore per brezat e ardhshem, ose duke i drejtuar efektet afatgjata te investimeve ne fuqine berthamore ose ne manipulimet gjenetike, cka jane vetem pak shembuj qe po permendnim ;
- **kompetenca te nje natyre procedurale**, te cilat shpresojme te jene te transferueshme dhe, po keshtu, te perdorshme ne nje mori situatash. Krahas kapaciteteve te ndryshme te pergjithshme intelektuale per te realizuar analiza apo per te bere sinteza, duhet te veme theksin ne dy kapacitete te perkatesise se vecante per te drejten demokratike te qytetarise dhe konkretisht : ne aftesine per te diskutuar, e cila lidhet me debatin dhe ne aftesine per te reflektuar, dmth me aftesine per te ri-shqyrtuar veprimet dhe argumentat nen dritet e parimeve dhe vlerave te te drejtave te njeriut , per te reflektuar mbi drejtimin dhe kufizimet e nje veprimi te mundshem, mbi konfliktet e vlerave e te interesave, etj.;
- **njohja e parimeve dhe vlerave te te drejtave te njeriut dhe te se drejtes demokratike te qytetarise**. Keto parime dhe vlera rrjedhin ne rradhe te pare nga nje konstrukt i arsyeshem, ndersa ne nje nivel me te thelle ato kerkojne qe konceptimi i qenies njerezore te bazohet ne lirine dhe dinjitetin e barabarte te cdo individ.

Familja e fundit con direkt ne fushen e dyte te kompetencave:

- **kompetencat etike dhe perzgjedhjet me vlere.** Individet e ndertojne vetveten dhe marredheniet e tyre me te tjeret ne perputhje me vlera te vecanta. Ky dimension etik, gjithnje i pranishem, perfshin aspekte afektive dhe emocionale. Disa njerez besojne se pranimi i vlerave te drejtave te njeriut dhe demokracise duhet te jete vetem rezultat i nje konstrukti racional. Te tjere besojne se nuk eshte e mjaftueshme te urdherohet pranimi /miratimi i tyre, ne menyre qe te sigurohet ajo. Aspektet afektive/terheqese dhe emocionale jane gjithnje te pranishme kur dikush e sheh veten si individ ne raport me te tjeret dhe me boten. Edukimi per te drejten demokratike te qytetarise kerkon gjithashtu te punohet me keto aspekte. E drejta e qytetarise nuk mund te reduktohet ne nje katalog te drejtash dhe detyrimesh, por duhet te drejtoje anetaresine ne nje grup ose ne grupe, duke i vene identitetet plotesisht ne levizje. Si pasoje kjo kerkon nje ndryshim etik, qe perfshin nje dimension emocional personal dhe kolektiv.

Te shumta ne numer sic edhe mund te jene, vlerat e perfshira, per te cilat puna ndertimore dhe refleksioni jane te domosdoshme, perqendrohen tek **liria, barazia dhe solidariteti**. Ato nenkuptojne njohje dhe respekt per vetveten dhe per te tjeret, aftesi per te degjuar, reflektuar mbi vendin qe ze dhuna ne shoqeri dhe menyren per ta kontrolluar ate, si dhe per te zgjidhur konfliktet. Ato kerkojne pranim pozitiv te dallimeve dhe te diversitetit, si dhe krijimin e besimit tek te tjere. Ne lidhje me kete, eshte e domosdoshme te kalohet pertej nje koncepti shume te ngushte te tolerances, nevoja per te cilen deklarohet shpesh. Eshte fakt se toleranca nuk kufizohet me pranimin e dallimeve, nje pranim i cili shpesh eshte mosperfilljes; ajo kerkon njohjen e kufizimeve te veta duke e konsideruar tjetrin ashtu sikurse edhe veten si pjese te njerezimit ; cdo individ ka nevojte qe te tjeret ta shohin si subjekt human/ nenshtetas; kjo reference ndaj vlerave eshte jashtezakonisht e rendesishme ne menyre qe te parandalohet instrumentalizimi i ligjit;

- **aftesite per te vepruar,** te njohura shpesh si **kompetenca sociale.** Njohurite, qendrimet dhe vlerat marrin kuptim ne jeten e perdritshme personale dhe sociale ; ato misherohen ne aftesite per te vepruar, ne kompetencat sociale, dhe ndihmojne per t'i dhene kuptim presences/ pranise se gjithesecilit tek te tjeret dhe ne bote. Kemi te bejme me ceshtjen e permiresimit te aftesise se njerezve per te ndermarre nisma dhe per te pranuar pergjegjesi ne shoqeri .Edhe nje here, eshte e pamundur te perpilohet nje liste e plote ; le te shohim, megjithate, disa nga keto aftesi/kapacitete te zakonshme qe i kemi permendur tashme:
  - **aftesia per te jetuar me te tjeret,** per te **bashkepunuar,** per te ndertuar dhe zbatuar projekte te perbashketa dhe per te marre persiper pergjegjesi. Me gjeresisht, kjo aftesi kontribon ne interkulturalizim, vecanerisht ne nevojten qe ndjejne njerezit per te mesuar disa gjuhe te huaja. Gjuhet e huaja konsiderohen, ketu, jo vetem si mjete te komunikimit me individet e tjere, por para se gjithash

si parashtrim menyra sh te tjera te mendoari dhe rruges sh per te kuptuar kulturat e tjera. Interkulturalizmi nuk ka te beje vetem me dimensionin linguistik/gjuhesor, ai perfshin gjith e aspektet e kultures, duke futur edhe historine.

- **aftesia per te zgjidhur konfliktet ne perputhje me parimet e ligjit demokratik**, ne vecanti dy parimet themelore per t'iu drejtuar nje personi te trete qe nuk eshte i perfshire ne konflikt dhe per te organizuar nje debat te hapur, ku te degjohen palet ne konflikt dhe te behen perpjekje per te zbuluar te verteten. Konfliktet mund te zgjidhen me ndermjetesim, me ane te se ciles synohet te arrihet nje marreveshje mes paleve ose sipas parimeve juridike, ku vendimi merret nga nje pale e trete, mbi bazen e ligjeve e te rregulloreve te shpallura para konfliktit ne fjale,
- **aftesia per te marre pjese ne debat publik**, per te debatuar dhe zgjedhur ne nje situat e reale.

Ne mund t'i kishim paraqitur keto kompetenca ne formen e nje trekendeshi me te tri kendet e tij , me kendin “ njohes”, ate “ afektiv dhe me vlere” dhe kendin “ social”, per t'i treguar lidhjet ne menyre vizuale. Asnje kategori nuk mund te perjashtohet nga te tjerat dhe ne cdo situat e keto tri kategori jane te ndervarura; ato perfaqesojne tri dimensione te pranise se seciles prej tyre ne bote dhe tek te tjeret. Keshtu, psh. zgjidhja paqesore e konflikteve nenkupton njohuri mbi parimet demokratike qe organizojne nje zgjidhje te tille, nje qendrim personal, i cili ka te beje me kontrollin ndaj dhunes dhe perjashton mundesine per ta vertitur ligjin sipas interesave te caktuara si dhe me aftesine per te vepruar ne lidhje me debatin. Pjesa me e madhe e kompetencave tashme te klasifikuara, i referohet gjithashtu dy fushave te tjera. Psh. argumentimi dhe debati kerkon njohuri lidhur me objektin e diskutimit, aftesi per te degjuar te tjeret dhe njohur pikepamjet e tyre, sikurse edhe ushtrim te ketyre aftesive ne situatat e duhura, ku njerezit gjejne vetveten. Nuk ka te drejte qytetarie me efektive sesa ajo qe vete individi e ushtron ne veprimet e tij dhe permes veprimeve te tij; dhe anasjelltas, njohja dhe reflektimi ndaj veprimeve te veta dhe rendesia e tyre sociale dhe personale, praktike dhe etike jane po aq te rendesishme. Sipas kriterave te kualifikimit e te edukimit, theksi duhet vene ne dimensionin me te dobet. Nje avantazh tjetër i ketij tipi konstrukti eshte se, ai perfaqeson nje instrument qe ndihmon vlersimin dhe riorientimin e veprimeve praktike.

## **4.2 Klasifikimi i dyte**

Nje klasifikim i dyte eshte propozuar, vecanerisht nga Ruud Veldhuis, i cili dallon 4 dimensione te se drejtes se qytetarie, dimensione te cilat bazohen ne nje analize te jetes ne shoqeri . Keto dimensione jane : politike dhe legale, sociale, kulturore dhe ekonomike. Sikurse edhe ne rastin e klasifikimit te pare, keto dimensione nuk jane qellime ne vetvete, por synojne te ndihmojne ne klasifikimin dhe sqarimin e kompetencave te Edukimit mbi te Drejten Demokratike te Qytetarie. Per disa, te katert

dimensionet janë të barabarta ; për të tjerë dimensionin politik dhe legal përfaqëson një dimension transversal / kalimtar, çështje të pushtetit e të ligjit ,që burojnë nga tri dimensionet e tjera, ai ekonomik, social dhe kulturor.

Për të shmangur rrezikun e perseritjes së disa nga informacioneve të dhëna në klasifikimin e parë, le të nënvizojmë përmbajtjen dhe qëllimet e secilës prej këtyre dimensioneve:

- **dimensioni politik dhe legal** përfaqëson të drejtat dhe detyrimet lidhur me sistemin politik dhe ligjin. Kjo kërkon njohuri mbi ligjin dhe sistemin politik, mbi qëndrimet demokratike dhe aftësinë për pjesëmarrje, dhe për të ushtruar përgjegjësi në të gjitha nivelet e jetës publike;
- **dimensioni social** përfaqëson marrëdhëniet midis individëve dhe kërkon njohuri se ku bazohen këto marrëdhënie dhe si funksionojnë ato në shoqëri. Kompetencat sociale janë shumë të mëdha, këtu. Ky dimension lidhet me të tjerët, në veçanti me të mëposhtimin, përmes peshës së vlerave që mbart, siç është psh solidariteti;
- **dimensioni ekonomik** përfaqëson botën e prodhimit dhe konsumit të të mirave materiale e të shërbimeve. Ai është direkt i hapur ndaj punës dhe mënyrës së organizimit të saj, ndaj rezultateve të punës dhe shpërndarjes së tyre. Ai kërkon kompetenca ekonomike dmth. njohuri mbi funksionimin e botes ekonomike, përfaqëson këtu tregun e punës;
- **dimensioni kulturor** i referohet përfaqësimeve dhe imagjinatave kolektive dhe vlerave të tyre . Ai nënkupton , sikurse edhe dimensionet e tjera, bile, shpesh herë edhe me shumë se ato, kompetence historike, njohje të trashëgimisë së përbashkët me gjithë komponentet e ndryshme të saj, të një trashëgimie të paqëndrueshme, të një trashëgimie që shkëmbehet me të tjerat. Kultura është gjithashtu e lidhur me kapacitete, të cilat formojnë bazën e shkollave tona në Evropë, të lexuarit dhe të shkruarit, si dhe aftësinë për t'u endur në një univers linguistik/gjuhësor dhe për të siguruar një tjetër. Të gjitha kapacitetet e fundit janë kushte të domosdoshme për gjithë Edukimin mbi të Drejtën Demokratike të Qytetarëve.

Megjithatë ndryshojnë në paraqitje, të dyja këto klasifikime vënë theksin në rëndësinë që ka krijimi i një ndërgjegjëje sociale kritike, dmth të një ndërgjegjëje mbi përkatesinë në botë, të një “ bashkë-qytëtarie” që përfaqëson qytetarë të cilët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre, dhe që, gjithashtu, kanë nevojë për një dimension me të gjërë, që qëndron përtej çdo problemi imediat e lokal. Një ndërgjegjëje e tillë sociale, por gjithashtu edhe historike dhe gjeografike, lidhet me zhvillimin e aftësisë për t'u terhequr, si dhe për të krijuar një forum publik për debat .

## 5. PRAKTIKAT

Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise nuk eshte thjeshte nje konstrukt teorik, por para se gjithash nje ftese e perditshme, dmth. nje ftese per te ushtruar lirite brenda kuadrit te percaktuar nga ligjet demokratike dhe te drejtat e njeriut si dhe per te ndermarre veprime per t'i konsoliduar keto liri dhe te drejta per te gjitha qeniet njerezore. Megjithate, le te kujtojme se nuk ka gje me absurde sesa te kundervesh teorine ndaj praktikës, reflektimin ndaj veprimit. Te jetosh dmth te mendosh e te veprosh ; te mendosh e te veprosh dmth te jetosh . Eksperienca eshte konceptuale : veprimi gjithnje na vendos ne kontakt me rrethanat dhe me kontekstin ne te cilen ndodh dhe me perceptimin e botes dhe te marredhenieve njerezore nga aktori. Aktivitetet e Keshillit te Evropes, vecanerisht ato te ndermarra si pjese e projektit te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise, per pasoje, perpiqen te kombinojne keto dy ane te ketij edukimi.

Pyetja mbi marredheniet midis teorise dhe praktikës nuk eshte aspak nje pyetje retorike. Ne kemi trashегuar menyra te ketyre marredhnieve ne fushen e arsimit, te cilat variojne midis dy polesh, dhe asnjeri prej tyre nuk eshte i kenaqshem ne vetvete: njeri pol, i cili favorizon te mesuarit e permbajtjes dhe njohurite mbi te drejtat e njeriut dhe te drejten demokratike te qytetarise, mbeshtetet ne nje arsye, qe merr persiper te gjeneroje/ krijojte nje sjellje qe t'i pershtatet kesaj njohje, tjetri i permbahet mendimit se vetem eksperienca mund te nxis nje njohje te thelle te nevojës per te vepruar ne perputhje me te drejtat e njeriut dhe me te drejten demokratike te qytetarise dhe se forca e kesaj nevoje do te gjeneroje me vone nje sjellje te pershtatshme.

### 5.1. Publiku objekt dhe fushat e nderhyrjes: te gjithë individet, te gjitha institucionet

Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise synon te gjithë individet, pavaresisht nga roli i tyre ne shoqeri. Ai kuresesi nuk mund t'u rezervohet personave te cilet jane margjinalizuar /anashkaluar ose qe kercenohen te perjashtohen. Njohja e te drejtave pranohet si esenciale per keta njerez, nese ata jane ne gjendje te shpetojne nga procesi i uljes ne nje shkalle me te ulet shoqerore, por nje njohje e te drejtave dhe detyrave eshte gjithashtu e nevojshme edhe per ata , te cileve u kerkohet te ushtrrojne pushtetin ne cdo nivel te shoqerise, dhe vecanerisht per ata, te cilet mbajne nje post ne organet e pushtetit publik. Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise nuk mund te jete nje menyre per ata, te cilet duke patur nje post ne organet shteterore, imponojne nje lloje pranimi social mbi te tjeret. Pergjegjesia me e madhe qytetare, nese nje kualifikim i tille do te ishte i pershtatshem ketu, u takon personave, te cilet kane me shume pushtet dhe pergjegjesi ne shoqeri.

Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise, per pasoje, shkon pertej ambjentit shkollor, ku u zbatua fillimisht. Kjo shfaqet si nje nevoje qe ndihet gjate gjithë jetes se njerezve dhe ne sfera te ndryshme te ekzistences se tyre. “ Fusheveprimet e te drejtes se qytetarise” - nje karakteristike kyce e projektit mbi Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarise- ilustron rendesine e kesaj metode te re. Fillimisht do te

prezantojme keto dhe me pas do te vazhdojme te shohim ne shkolla e ne ambjente te tjera te mundshme veprimi, ku nxitet zhvillimi i se drejtes demokratike te qytetarise.

## 5.2. Fusheveprimet e se drejtes se qytetarise

Fushat e veprimit te se drejtes se qytetarise jane forma te reja ose novatore te menaxhimit te jetes demokratike. Keto fusha perfshijne cdo iniciative ( qender, institucion, komunitet, fqinj, qytet, rajon etj), ku behen perpjekje per te percaktuar dhe zbatuar parimet e se drejtes demokratike moderne te qytetarise. Ky ambient eshte nje praktike, apo nje seri praktikash, te cilat ilustrone kuptimin qe merr e drejta e qytetarise dhe strukturat qe e mbeshtetin ate ne kohen moderne. Ky eshte percaktimi i ketij koncepti specifik per projektin “ Edukimi per te drejten Demokratike te Qytetarise”, sikurse parashtrohet ne raportin e aktivitetit te vitit 1998.<sup>8</sup> Kjo i shenderon ato ne nje mjet te metejshem ne zbatimin e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise krahasuar me metodat tradicionale, te cilat ndeshen kryesisht ne institucionet ekzistuese sic jane shkollat . Keto metoda jane te pershtatshme ne pune me te rinjte, te cilet nuk ndihen rehat ose qe kane arritur rezultate te ulta ne shkolle dhe presupozojne nje perspektive te mesuari gjate gjithë jetes.

Keto fusha veprimi, dhe menyra sesi percaktohen, studiohen dhe perdoren ato, reflekton qarte synimin e ri te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise. Psh , ato mbulojne nje numer te madh projektesh, inkurajojne partneritete dhe, ne kete menyre, pershijne shume lojtare te ndryshem, zbulojne forma te ndryshme pjesmarrjeje, luftojne perjashtimin etj ; ato mbeshteten ne vlerat dhe proceset demokratike, qe synohen te nxitin e konsolidohen prej tyre.

Ne keto ambjente, zhvillimi i kompetencave te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise kombinohet me veprimin per te ndertuan mbi to dhe per t'i forcuar ato. Fushat e veprimit jane, rrjedhimisht, ne gjendje te perfshijne nje numer aktivitetesh si psh – koordinimi me projektet lokale, ngritja e komiteteve te komunikimit nderkulturor per ndermjetesim midis komuniteteve te ndryshme, per te mesuar te rinjte qe vijne nga rrethet me te varfra te njohin te drejtat dhe pergjegjesite e tyre, ndermarrja e projekteve per te pajtuar komunitetet e ndara nga lufta, krijimi i nje klime demokratike ne shkolla etj .<sup>9</sup> Kudo ku zhvillohen, keto aktivitete sigurojne mundesi per t'u shprehur dhe per te negociuar, identifikojne nevojat per kualifikim dhe vene theksin ne nevojen e autoriteteve per te mbajtur nje qendrim te hapur e me vend. Nje nga menytrat me premtuese per krijimin e nje ambienti demokratik Evropian ka te beje me vendosjen e nje dialogu midis te gjitha ketyre fushave, me ane te teknologjive te reja. Nje dialog i tille mund t'i ndihmoje individet e perfshire, te dalin nga ambjentet e tyre shpesh te ngushta e te kufizuara, me qellim qe , te shkembejne eksperienat e tyre dhe te nxisin iniciativa te reja.

---

<sup>8</sup> Shiko dokumentin DECS/CIT ( 98) 38 rev.

<sup>9</sup> Shiko dokumentin DECS/EDU/CIT (99) 40.

### 5.3 Praktikë në ambientin shkollor

Aktualisht shkollat ndodhen në siklet të madh. Nuk ka vend për të analizuar argumentat tepër kontradiktore që janë parashtruar ose nevojat e ngutshme, po ashtu kontradiktore, me të cilat shkollat po përballen gjithnjë e më shumë. P.sh. si do të mund të siguronim një nivel minimal barazie në mundësitë për të përfunduar njohuri apo për të grumbulluar aftësi kur shkollat me kërkesën e vetë shoqërisë bëjnë klasifikimin apo përjashtimin e njerezve? Si mund ta parandalojmë njohjen e diversitetit kulturor, tipet e ndryshme të inteligjencës dhe menyrat e mesimit nga tërheqja drejt identiteteve dalluese dhe intensifikimit të pabarazive? Ndoshta është mirë të mbajmë parasysh faktin se, kur behet fjale për edukimin mbi të drejtën demokratike të qytetarëve, shkollat bien/falimentojnë atëherë kur bie edhe shoqëria dhe se ato, shpesh, janë të vetmet institucione të qëndrueshme, të cilat sigurojnë gjithçka për një grupmoshë të vecantë dhe përpiqen të luftojnë kundër kërcënimeve që drejtohen ndaj kohezionit social. Por, këtu, serish shkolla nuk mundet që vetë, ta rruajë kohezionin social dhe të transmetojë vlerat e saj, pasi ajo vetë është pjesë e një bote, ku ky kohezion po shkaterohet apo është në metamorfozë, dhe ku këto vlera janë, çdo ditë, nën sulmin e dhunës fizike dhe mendore dhe të forcës së një lloji të gare financiare, që injoron edhe vetë konceptin e solidaritetit. Kjo dhunë dhe kjo garë përcillet, ditë e natë, nga media.

Mbi dhe përtej gjykimeve mbi shkollat dhe ndryshimeve që u nënshtrohen ato, duhet të themë se ato mbeten serish institucione vitale, të cilat merren me Edukimin për të Drejtën Demokratike të Qytetarëve. Në shkollë duhet të kihet parasysh të tri tipet e kompetencave, të përcaktuara në klasifikimin e parë: kompetencat njohëse, kompetencat etike dhe kompetencat e lidhura me veprimin. Ka tri rrugë të ndryshme për t'iu shërbyer atyre: jeta shkollë, dmth gjithë aspektet e shkolles si një ambient i gjallë social me rregullat e saj kolektive, me konfliktet ndërpersonale, me kohë dhe mundësi kooperimi etj; vetë leksionet, të cilat janë kushte për t'u pranuar në shkollë; dhe koha, vendet dhe mundësitë për ndërmarrjen e iniciativave spontane nga nxënësit jashtë aktivitetëve aktualë shkollorë. Megjithatë Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarëve përfshihet në shkollë. Nderkohë duhet të kujtojmë se Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarëve duhet të shoqërohet nga afër krijimin e njohurive, praktikave dhe veprimeve, duke reflektuar në mënyrë kritike ndaj secilit prej tyre, me qëllim përpunimin e parimeve dhe vlerave që qëndrojnë në themel të këtij edukimi dhe t'i spjegojë ato. Nëse shkolla i edukon njerezit me të drejtën Demokratike të Qytetarëve, ajo duhet të sigurojë, në mënyrë të vazhdueshme, se menyrat me të cilat ajo operon nuk bien në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Kjo nuk është një çështje që ka të bëjë me shëndërimin e shkolles në një forum permanent, por me tëpër një çështje që ka të bëjë me paraqitjen e strukturave, sikurse është bërë në një numër vendesh, për dialog, shkëmbime, drejtim dhe pjesëmarrje. Nga njëra anë, duhet të theksojmë nevojën për t'i dhënë kohë nxënësve për të ndërmarrë iniciativë dhe për të ushtruar përgjegjësi dhe nga ana tjetër, duhet të theksojmë rëndësinë e zhvillimit të rrugëve të ndryshme për menaxhimin e shkolles, çka i lejon të gjithë, të rinjë e të ritur, të përjetojnë respektimin e të drejtave të tyre. Kemi të bëjmë kështu, me

te njejtat orientime thelbesore si ato qe formojne bazen e fushave ku vepron e drejta e qytetarise.

Edukimi shkollor bazohet ne permbajtjen e mesimdhenies e te kualifikimit, te inkuadruara ne ato cka quhen disiplina apo lende mesimore. Duke u nisur nga kendveshtrimi i sjelljeve dhe marredhenieve mes individeve, duhet thene se te gjitha lendet jane me interes, sepse ne rrethanat e procesit te mesimdhenies e te kualifikimit shfaqen individe, veprimet e te cileve duhet te respektojne parimet e te drejtave te njeriut. Edhe ketu serish eshte e pamundur te vihet theksi kaq shume ne kompetencat qe lidhen me degjimin, dialogun, pjesemarrjen dhe pergjegjesine.

Persa i perket permbajtjes, te 4 dimensionet, ai politik dhe ligjor, social, ekonomik dhe kulturor qendrojne dukshem ne rradhe te pare. Vendin me te privilegjuar e zene te gjitha disiplinave te shkencave sociale, te cilat ne studimet mbi shoqerite e kaluara dhe ato aktuale, krijojne menytrat e kuptimit te jetes sociale, ekonomike, politike dhe kulturore, menyra keto, te cilat perfshijne nje dimension historik dhe nje dimension territorial dhe jane te lidhura me vlerat dhe konceptimet humane .

Ndersa shkencat shoqerore zene nje vend te dukshem, lendet e tjera mesimore perfaqesojne nje mbeshetje te shendoshe ne Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarise. Nje gje e tille demonstohet ne nje numer studimesh. Permendim ketu rastin e gjuheve te huaja dhe edukimin artistik, gjithcka qe lidhet me krijimtarine dhe shkembimet kulturore. Te mesosh nje gjuhe te huaj dmth gjithashtu te mesosh nje kulture, nje menyre tjeter per kategorizimin dhe cilesimin e botes, nje menyre tjeter te shprehuri dhe po keshtu , te krijuari te mendimeve dhe emocioneve .Zhvillim i arsimit artistik do te thote te mesosh gjuhe te tjera nga gjuha amtare per te shpjeguar boten dhe lidhjet me te, kjo do te thote te dish te ballafaqohesh me punen e te tjereve. Kjo i shton ne menyre te konsiderueshme fushat e veprimit te iniciativave dhe aktiviteteve per te ndertuar kompetencat qe kerkohen nga e drejta demokratike e qytetarise. Shkencat japin gjithashtu nje kontribut te rendesishem, se pari ne permbajtje, pasi bota ne te cilen jetojme ndikohet/influencohet gjithnje e me shume nga shkenca dhe teknologjia dhe, se dyti , me metodat dhe kualifikimin intelektual- vecanerisht kritik- permes mbrujtjes me deshiren per te verteten , rendjes pas argumentit racional, zoterimit te gjuhes se perpikte dhe nxitjes se imagjinates.

Ne kete liste te shkurter te lendeve mesimore tradicionale, te ofruara ne shkollat e mesme, dhe ne disa raste edhe ne shkollat fillore, duhet te shtojme teknologjite e reja, te cilat me gjithte diversitetin e formave te tyre fizike, te potencialeve dhe perdorimit te tyre, zene vend edhe ne Edukimin per te Drejten Demokratike te Qytetarise. Te kuptuarit dhe te zoteruarit e tyre con gjithashtu ne krijimin e kompetenca te reja, per te cilat nevojitet arsimim dhe kualifikim.

Pavaresisht nga lenda mesimore dhe permbajtja, te gjitha studimet e fundit vene theksin ne pavaresine e nxenesve ose te mesuesve ne zbatimin e metodave aktive qe kerkojne iniciative, aftesi zbuluese, ndjenje hetimi, pergjegjesi dhe eksperimentim te strukturuar e te menduar rigorozisht.

Dhe se fundi, shkollat po drejtohen drejtpersedrejt ndaj ketyre fenomeneve, te cilat, deri kohet e fundit, kane qene jashte experiences se tyre te perditshme – fenomene keto, te cilat tani grupohen se bashku nen titullin “ dhune”. Studimet mbi dhunen e ushtruar ne shkolla gjate 10 viteve te fundit i dekurajojne pergjithesimet e shpejta. Edhe nje here, eshte e rendesishme te vleresohet moria e situatave dhe shumellojshmeria e veprimeve nen termin “ dhune”. Eshte absolutisht esenciale te kihet parasysh ky diversitet, ne menyre qe te shmangim imponimin e skemave te gabuara dhe marrjen e masave ose vendime qe vetem se do ta keqesonin problemin .Sigurisht qe shkollat nuk mund te jene gjithcka , po keshtu, te vetme ato nuk mund t’i kurojne semundjet sociale dhe ndonese ato vete perfshihen nga konfliktet dhe kontradiktat e shoqerive tona, ato duhet te japin nje kontribut te rendesishem ne zgjidhjen e problemeve te dhunes. Sikurse ne kontekste te tjera, dhe ne ato arkitipike/ origjinale, ne te gjitha studimet mbi dhunen nenvizohet fakti se perpjekjet ndaj saj duhen fokusuar ngushtesisht ne situatat individuale dhe se ato kane nevojte per veprim te vendosur nga ana e te riturve, bashkepunim mes tyre, dialog te rregullt e te duruar me nxenesit dhe te rinjte, krijim te lehtesive ne komunimim dhe ne perdorim metodash per zgjidhjen e konflikteve ose me ndermjetsim ose- ne rastet me serioze-me ndihmen e sistemit te drejtesise. Nje veprim i tille lidhet gjithnje me parimet dhe vlerat e te drejtave te njeriut. Keshtu psh., zgjidhja e konfliktit lidhet me thirrjen e nje pale te trete dhe me debate te karakterizuara nga polemika. Gjithe kjo dmth se te riturit duhet te adoptojne qendrimet dhe sjellje te pergjegjshme. Keshtu, ne nuk mund te kerkojme me shume pergjegjesi nga te rinjte dhe, me pas, te veprojme sikur situata te tilla jane te parendesishme. Dhe se fundi, nje vemendje e vecante i duhet kushtuar viktimave. Ligji ndeshkon , mbron dhe kompenson ; me konkretisht , ligji kerkon qe personat , qe kane autoritet e pergjegjesi, te garantojne se shkeljet e ligjit dhe fyerjet jane te ndeshkueshme, se viktimat duhen kompensuar dhe pajtuar dhe se njerezit duhen mbrojtur nga aktet e dhunes dhe nga gjithte dhunimet e tjera qe u behen te drejtave te tyre.

Nje aspekt final i shkollimit lidhet me edukimin mbi te drejtat . Ndonese ne shumicen e shteteve, te rinjeve u garantohen te drejtat e plota kur arrijne moshen e pjekurise ( zakonisht ne moshen 18 vjecare) kjo nuk do te thote se nen kete moshe ata nuk gezojne te drejta. Prandaj ata duhet te mesojne mbi keto te drejta dhe rendesine e tyre. Qellimi nuk eshte t’i bejme ata avoketer, por te formojme qytetare, qe njohin te drejtat dhe pergjegjesite e tyre dhe, qe rrjedhimisht, jane ne gjendje te veprojne ne shoqeri ne perputhje me keto te drejta. Te rinjte nuk mund te zhvendosen papritur nga nje gjendje vartesis totale nga ana e prinderve apo kujdestareve te tyre ne nje gjendje te lirise se plote, kur ata arrijne moshen e pjekurise. Te drejtat e minoreneve variojne/ kalojne nga nje gjendje ne nje tjetere. Kudo minorenet i nenshtrohen disa detyrimeve specifike dhe lirite e tyre rriten gradualisht se bashku me rritjen e tyre ne moshe. Sikurse edhe fushat e tjera te Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise, edhe kjo nuk eshte nje menyre teorike, por nje induksion ne te drejten qytetare, e cila fokusohet ne jeten e perditshme, nderkohe qe perpiket te siguroje nje fushe veprimi per te shpjeguar parimet dhe vlerat, mbi te cilat bazohet. Shqetesim per edukimin mbi te drejtat nuk eshte menjehere evident ne studime specifike, vecanerisht ne ato qe lidhen me nje fushe te caktuar te se drejtes se qytetarise, por ai/ ky shqetesim eshte shpesh i pranishem dhe qendron ne baze te shume raporteve .

## 5.4 Edukimi gjate gjithë jetes dhe fushat e tjera

Nje fushe tjeter e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise eshte edhe edukimi ose kualifikimi gjate gjithë jetes. Per kete ceshtje ekziston nje mendim i perbashket. Sot as qe mund te mendohet se edukimi i nje personi /individidi eshte i plote pasi ky i fundit ka mbaruar shkollen ose universitetin. Edukimi shkollor eshte nje e drejte, e cila njihet ne te gjitha shtetet demokratike dhe zbatimi i kesaj te drejte rezulton ne zhvillimin e institucioneve ad hoc; e njejta gje eshte e vlefshme edhe ne rastin e edukimit gjate gjithë jetes. Kjo kerkon zbatimin e politikave te gjithanshme ekonomike dhe arsimore. Ky edukim nuk mund te reduktohet vetem ne nje aspekt teknik apo profesional; ai duhet te perfshije gjithcka qe e shqeteson individin, punetorin dhe qytetarin. Dimensioni i se drejtes se qytetarise eshte gjithnje i pranishem, edhe ne rastet kur synon te rruaje nje nivel te larte aftesie tek disa persona ose kur synon te lehtesoje rivendosjen / kthimin e kategorive tashme te perjashtuara.

Mes publikut objekt i ketij kualifikimi gjate gjithë jetes, duhet te gjendet nje vend i vecante per ata, te cilet jane pergjegjes per arsimin dhe kualifikimin, si ne shkolla ashtu edhe ne disa kuadre te tjera institucionale. Gjithnje e me shpesh autoritetet publike deshtojne ne nxjerrjen e konkluzioneve te pershtatshme nga mbrojtja qe i behet edukimit dhe kualifikimit per te drejten demokratike te qytetarise, ose te kualifikimit te instruktoreve. Theksi qe vihet mbi instruktoret rrjedh nga interesimi per te perfshire, ne kete drejtim, sa me shume individe dhe grupe qe te jete e mundur , si dhe nga nevoja per “ ndermjetes”, te instruktuar vecanerisht per kete pune.

Edukimi gjate gjithë jetes me te drejten demokratike te qytetarise realizohet ne nje numer te madh vendesh. Qendrat e punes dhe firmat jane nga me te rendesishmet ne kete drejtim. Megjithate, eshte e vertete se firmat nuk parashikojne kualifikimin e qytetareve, por si cdo institucion tjeter social ato kane per detyre te operojne ne perputhje me te drejtat e njeriut , qofshin keto te drejta te shprehura individualisht ose kolektivisht. Edhe firmat gjithashtu, jane vende ku realizohet kualifikimi me te drejten e qytetarise.

Dhe se fundi, i referohemi serish nevojës per te marre parasysh individe dhe institucione, te cilet , ne nje menyre ose ne nje tjeter, kane ose do te kene autoritet/ pushtet mbi te tjeret. Po keshtu edhe perpjekjet per te zbatuar kualifikimin per te drejten demokratike te qytetarise ne institucionet e arsimit te larte dhe ne media, apo edhe ne institucionet publike si psh ne polici apo ne sistemin e drejtesise, jane po keshtu te nevojshme dhe te keshillueshme. Edhe nje here, eshte e rendesishme te degjohen dhe te merren parasysh projektet e inicuar nga shoqeria civile dhe qe autoritetet publike te shihen si organe qe u sherbejne qytetareve.

## 5.5 Metodatat konvergjente, veshtiresite e ngjashme

Gjitha keto praktika dhe eksperiencia, gjitha keto vende dhe ambiente zbulojne/ nxjerrin ne pah nevoja te krahasueshme. Kudo theksi bie mbi rendesine qe ka dialogu, vemendja qe duhet treguar per te degjuar dhe marre ne konsiderate ate cka thone te tjeret, per t'i inkurajuar ideve te tyre dhe po keshtu edhe vete individet qe i shprehin keto ide. Shpirti i iniciatives, i pjesemarrjes dhe i pergjegjesise, po keshtu, mbeshtetet ne menyre universale, dhe kerkon veprime dhe praktika, te cilat nga ana e tyre, kerkojne veprim personal dhe kohe. Pikerisht ketu Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise mund te shihet me mire si proces. Partneritetet dhe bashkepunimi eshte gjithnje i nevojshem midis individeve, midis shoqatave, shoqatave jeqeveritare/ NGO-ve dhe grupeve te tjera, dhe midis shoqatave dhe autoriteteve lokale e te tjera. Pikerisht mbi bazen e nje dialogu te tille, te iniciativave dhe te partneriteteve te tilla, perjetohen dhe ndertohen marredheniet me te tjeret. Dhe se fundi, ne rrethana ku trajnimi ka nje qellim me ekspllicit /te qarte, theksi bie ne studime zhvillime mbi mjedisin, duke i trajtuar si shembuj qe kane nevoje per zgjidhje dhe duke i pare si mjete per t'i dhene forme konkrete parimeve dhe vlerave te se drejtes demokratike te qytetarise.

Megjithate, situata eshte larg te qenit utopike. Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise po perballet me veshtiresi te panumerta. Keto veshtiresi rrjedhin zakonisht nga faktore dhe situata te ndryshme, te cilat ne i kemi paraqitur shkurtimisht ne kontekstin e tyre perkates. Shpesh eshte problem pasi kushtet social-ekonomike nuk jane te mira; perjashtimi nga format kryesore te integritit ne shoqeri, vecanerisht nga puna, e ben te veshtire mesimin mbi te drejtat dhe pergjegjesite. Besimet dhe gjykimi i shendoshe behen shpesh pengese per te drejten demokratike te qytetarise; njerezit nuk i besojne metodet se zgjidhjes se konflikteve, e cila i permbahet parimeve demokratike, nderkohe qe dhuna dhe hakemarrja individuale mbeten zgjidhjet me te pranueshme; te tjere nuk e kuptojne se perse duhet t'u permbahen parimeve demokratike, kur rregullat e konkurences nenkuptojne se me i forti fiton dhe ,si pasoje, me i dobtu humbet, kur mashtruesit shume shpesh jane edhe te fituarit .Te tjere theksojne kufijte e praktikave pjesmarrese, te hapura ne shkolla; edhe kur ky qellim nuk vihet ne pikepyetje ekziston nje rezistnce e madhe ndaj tij si nga te riturit ashtu edhe nga te rinjte. Nga te parat, mesuesit kane patur me pak kualifikim ne kete fushe dhe jane fshehur pas detyrimeve te rregulloreve shkollore dhe programeve mesimore, nderkohe qe autoritetet shkollore e kane zet te heqin dore nga komperencat e tyre dhe e shohin pranine e prinderve si problematike dhe ngandonjehere edhe si kontradiktore ; nxenesve, nga ana tjetere, u mungon besimi per marre pjese ne kete drejtim, ata i shohin mbledhjet e komitetit te nxenesve si te merzitshme dhe shpesh e ndjejne se ndaj pikepamjeve te tyre tregohet shume pak vemendje.

Veshtiresi te tjera burojne gjithashtu nga rrethana te ndryshme qe paraqiten ne shtete te ndryshme, ne vartesi te historise se tyre. Ne shume studime behet dallimi midis shteteve ish komuniste dhe vendeve te tjera, pasi te parat kane kaluar nje periudhe te gjate totalitare, qe i izoloi ato nga institucionet demokratike. Ky dallim duhet trajtuar me kujdes. Se pari, sepse keto shtete nuk kane te njejten histori, pasi disa prej tyre e kane njohur demokracine qysh para Luftes se Dyte Boterore dhe te tjeret kane pak ose nuk

kane aspak nje eksperience te tille.Se dyti, disa nga keto vende i jane nenshtuar sundimit diktatorial per nje periudhe kohe shume te gjate.Dhe se fundi, shtetet me demokraci me te konsoliduar jane ato qe jane ngritur pas shkaterrimit te vagonjeve sociale e politike, duke perballuar sfida dhe probleme qe ne ,te gjithë, jemi te detyruar te perballojme e te zgjidhim, dhe duke hartuar parimet dhe vlerat e se drejtes demokratike te qytetarise dhe te drejtat e njeriut.

## 6.DISI RREZIQE

Pas parashtrimit te mendimeve te tyre mbi konceptet dhe klasifikimin e kompetencave dhe pas analizes mbi rendesine e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise, moria e praktikave te perfshira dhe menytrat e ndryshme, mbi bazen e te cilave ato jane futur ne shkolla e gjetke, disa autore paraljmerojne per rreziqe te vecanta. Para se ta perfundojme kete studim dhe duke vene theksin, serisht, ne rendesine e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise dhe ne problemet e tensionet specifike te lidhura me te, do te rendisim rreziqet me te zakonshme qe mund te shfaqen, duke perfshire edhe disa te tilla, te cilat ne tashme i kemi permendur:

- zgjerimi *ne infinit* i kompetencave, qe synohet te arrihet permes Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise dhe fushave te lidhura me te. Per me teper, meqense qytetari eshte nje person i informuar dhe i pergjegjshem, i afte te marre pjese ne debate publike dhe te beje zgjedhje, asgje qe eshte humane nuk mund te jete e panjohur per te,dhe asgje qe perjetohet nga shoqeria nuk mund te jete e huaj per te drejten demokratike te qytetarise.Rreziku eshte real dhe ne shohim shume situata ku, ne emer te ketij zgjerimi, Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise reduktohet ne menyre paradoksale ne mesimin e sjelljeve kolektive, qe perputhen me zakonet tona kulturore. Ky aspekt i edukimit eshte shpesh shume i rendesishem, por Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise, ne nje menyre apo ne nje tejter, ka te beje me ceshtje qe lidhen me pushtetin dhe ligjin, dryshe ai nuk do te jete as demokratik e as qytetar(civil).
- burokratizimi i institucioneve te kualifikimit dhe atyre arsimore dhe deshtimi i mesuesve dhe instruktoreve ne ndarjen e kompetencave te tyre. Ky problem ka lindur tashme ne shkolla dhe po behet gjithnje e me akut ne sistemin arsimor per te ritur : mendimet e shprehura nga nxenesit ose stazhieret duhet te merren seriozisht ne konsiderate.Pikepamjet e tyre jane, ne pamje te pare, autentike dhe duhet te degjohen e te konsiderohen si te tilla, edhe nese, ne te njejten kohe, ato perfaqesojne nje objekt, fokus apo mbeshtetje te aktivitetit te kualifikimit dhe te edukimit;
- Kufizimi i Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise ne rrethana te veshtira. Tashme eshte kritikuar nje tendence e rendomte, sipas se ciles Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise eshte me interes vetem per personat qe rrezikohen te largohen( nga puna, vendi) ose qe ndodhen ne kushte te veshtira social-ekonomike. Nese harrojme thelbin e se drejtes se qytetarise dhe te

kompetencave qe kerkon ajo, ekziston rreziku i reduktimit te saj ne nje moral te vaget sjelljeje, qe pavaresisht nga cilesia e mesuesve ose instruktoreve, shenderohet ne nje ndermarrje, ku realizohet normalizimi fizik e mendor i individit. Ky thelb kerkon t'i kushtohet sa me shume vemendje edukimit dhe kualifikimit te atyre individeve, te cilet jane ne gjendje te ushtrojne pergjegjesi shoqerore apo qe kane nje post ne organet drejtuese publike. Parashtimi i mendimeve mbi pergjegjesine dhe pjesemartjen ka te beje me pranimin e nje rreziku te madh, dhe pikerisht te rrezikut qe lidhet me ndarjen e pushtetit. Flitet shume per nje rrezik sipas te cilit njerezit me pushtet " ne periferi" po grumbullojne vetem te drejta pa asnje detyrim, duke krijuar tek ne friken se keta " marginale " do te kerkonin vetem te drejta, mbi te cilat, pushtetaret do te preferonin te rruanin kontrollin e tyre;

- Reduktimi i Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise ne nivel lokal, ne grupe qe ndeshen ne jeten e perditshme. Puna ne kete drejtim eshte shume e dobishme dhe integrimi lokal eshte shpesh kusht i domosdoshem per krijimin e nje identiteti. Por, ne nje bote qe eshte shume e hapur, me levizje te lire te mallrave, dhe ne vecanti te te mirave kulturore dhe informacionit, referencat e tjera jane shume prezente dhe kane nevojte te merren ne konsiderate, qofte kjo ne nivel lokal, apo jo. Dhe se fundi, nuk duhet harruar se ndersa disa individe ndodhen , ne nivel lokal, ne veshtiresi dhe se beteja kunder perjashtimit te tyre kerkon riintegrim lokal, te tjere mendojne papritur ne shkalle kontinentale dhe globale. Te mendosh per keto nivele eshte gjithashtu nje aftesi e nevojshme per te kuptuar dhe ushtruar te drejtat si qytetar:
- Dykuptimshmeria e fjaleve dhe reduktimi i tyre ne ate cka na pershtatet ne nje moment te dhene. Ne jemi perpjekur te analizojme, sa me shpesh te jete e mundur, konceptet dhe kompetencat e Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise, duke i vene ato ne pikepyetje dhe duke i provuar /testuar ato. Asnje nga keto koncepte dhe asnje nga keto kompetenca nuk mund te izohet brenda kufijsh e kuptimesh strikte, te mbyllura, te ngurta dhe unike. Keshtu, gjithsecila prej tyre duhet te rimerret ne konsiderate si nga pikepamja teorike ashtu edhe lidhur me kontekstin, ne te cilen perdoret dhe situaten me te cilen lidhet . Fjala " tolerance" ketu eshte nje shembull i mire;
- Kalimi i dimensionit politik drejt atij kulturor. Fenomenet aktuale te globalizimit dhe kriza ne institucionet tona politike demokratike i bejne shume njerez qe te kerkojne, ne kulture, afirmimin e te drejtave te reja, te afte te njohin entitete te tjera publike nga ato qe deri me sot kane dominuar universin politik demokratik. Ekonomia e tregut, demokracia dhe shtetet demokratike, diversiteti kulturor, identiteti kolektiv dhe levizja e lire e njerezve ( ne nje fare menyre) , e ideve ( nen kontrollin e pak kompanive te fuqishme ), e mallrave ( qe rritet vazhdimisht ) perfaqesojne nje mori shume te madhe konceptesh dhe realitetesh, te cilat ende nuk kane perfunduar se shqyrtuari, si lidhur me vete ato ashtu edhe, per me teper, me marredheniet qe ato kane mes tyre.

## **PIKAT E PEZULLIMIT**

Te drejtat e njeriut, kultura dhe kultura demokratike nuk perhapen si gripi ! Nuk eshte aspak e natyrshme t'i konsiderosh qeniet njerezore si te barabarta apo te deklarosh se te gjitha duhet te marrin pjese ne hartimin e ligjit , se liria eshte pasuria e pare e njerezimit dhe ciltersia ndaj te tjereve nje kusht i vecante i ekzistences se saj. E gjitha kjo duhet te mesohet dhe duke u nisur nga ky fakt u kerkohet qytetareve, edukatoreve dhe instruktoreve te veprojne. Pavaresisht nga bindjet, veprimet e tyre nuk do t'ia vlenin shume, nese shoqeria dhe autoritete, qofshin keto publike ose private, nuk do t'i perkrahnin ato me shume e jo vetem me fjale, cka do te perkeqesohej/acarohej nese ata do te vepronin ne nje menyre te papajtueshme me te drejtat e njeriut dhe demokracine. Edukimi per te Drejten Demokratike te Qytetarise mund te jete kuptimplote vetem nese ekziston nje lidhje e vertete me pjesen tjeter te shoqerise.

Keshtu asgje nuk mund te quhet e sigurte dhe nevojat jane te medha. Eshte e rendesishme te mbahet gjithnje parasysh kontributi teorik dhe praktik i konceptit mbi te drejten demokratike te qytetarise. Disa fjale kyce te perdorura rendome ne kete studim, e qe i bejne jehone prezences se tyre ne tekstet e Keshillit mbi te cilat bazohet, ilustrrojne nevojten per nje kuader te tille referencash si : liria, barazia, pjesemarrja, pergjegjesia dhe solidariteti. Liria si aftesi per veprim, barazia si mundesi e te gjithëve per te mira materiale dhe sherbime baze ne menyre qe te mbrohet dinjiteti human, pjesemarrja si nevoje per te kontribuar per interesin e pergjithshem, pergjegjesi per vete, te tjeret dhe te ardhmen e botes dhe solidaritet mes popujve duke kapercyer barrierat politike, kulturore dhe sociale. Keto jane dhe mbeten thelbi i Edukimit per te Drejten Demokratike te Qytetarise.

**Perkthyer nga: Svjetllana Mihali**

**Perkthimi u mundesua nga US.**